



# PARKU I QYTETIT PËR TË GJITHË

RAPORT I PUNËTORISË SË VIZIONIMIT PËR PARKUN  
E QYTETIT TË PRIZRENIT TË QASSHËM PËR TË GJITHË

tetor, 2016



**PARKU I QYTETIT PËR TË GJITHË**  
**RAPORT I PUNËTORISË SË VIZIONIMIT PËR PARKUN E QYTETIT**  
**TË PRIZRENIT TË QASSHËM PËR TË GJITHË**

**Autore e raportit dhe**  
**udhëheqëse e projektit të vizionimit:**  
**ROZAFI BASHA, arkitekte**

**Asistentë në realizimin e hulumtimit dhe grafikës:**  
**DHURATA AVDIU dhe EGZON BAJRAMI, studentë të arkitekturës**

*Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit **Prizreni, një qytet pa pengesa**, që përkrahet financiarisht nga USAID, programi E4E dhe mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK.*



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA





## **PËRMBAJTJA:**

### 0.0. Hyrje

#### 1. Punëtorja e vizionimit parku i qytetit për të gjithë

##### 1.1. Pëshkrimi i lokacionit

##### 1.2. Qëllimet e punëtorisë së vizionimit

##### 1.3. Materialet e punëtorisë

##### 1.4. Komuniteti i përfshirë në punëtori

##### 1.5. Metodologjia e punës

#### 2. Rezultatet nga punëtorja

##### 2.1. Rezultatet e anketimit të komunitetit gjatë punëtorisë

##### 2.2. Propozimet e dala nga puna me komunitet gjatë punëtorisë

#### 3. Vizioni i parkut të qytetit për të gjithë

##### 3.1. Identifikimi i barrierave fizike dhe I problemeve të tjera në

##### Parkun e qytetit

##### 3.2. Vizioni i parkut të qytetit të Prizrenit për të gjithë

##### 3.3. Koncepti për parkun e qytetit të qasshëm për të gjithë

##### 3.4. Rekomandimet dizajnuese për realizimin e parkut të shfrytëzueshëm nga të gjithë qytetarët

#### 4.0. Shtojcat

**FOTOGRAFITË:**

Fq. 4-9; fq.32-37 © Rozafa Basha, Dhurata Avdiu dhe Egzon Bajrami

Fq. 8 © EC Ma Ndryshe dhe OPDMK

Fq. 19-31, foto të marra nga webfaqe të ndryshme.

**FIGURAT:**

Fq. 3 dhe fq. 34-66, © Rozafa Basha, Dhurata Avdiu dhe Egzon Bajrami

**KOPERTINA:**

© Egzon Bajrami dhe Rozafa Basha



## **PARKU I QYTETIT TË PRIZRENIT PËR TË GJITHË**

### **HYRJE**

Eliminimi i barrierave arkitektonike në qytet për të mundësuar lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara, por edhe të komuniteteve të tjera që një moment të caktuar mund të kenë pamundësi për të lëvizur, është kushti themeltar i barazisë dhe demokracisë në një qytet. Të gjithë kanë të drejtë të jetojnë dhe ta shfrytëzojnë qytetin, si dhe t'i gëzojnë të mirat që ai mund t'i ofrojë atyre. Qytetet që mund ta ofrojnë këtë për të gjithë personat, pa dallim gjinie, aftësie, moshe, etnie, orientimi seksual dhe mundësie financiare quhen qytete gjithëpërfshirëse.

Janë shumë grupe dhe komunitete që për shkak të barrierave të ndryshme fizike, por edhe kulturore dhe institucionale janë të marginalizuara nga pjesëmarrja në aktivitetet e përditshmërisë në qytet. Në Kosovë, kjo është mjaft e evidente, meqë qytetet janë planifikuar dhe ndërtuar për pa marrë parasysh kërkesat e të gjitha komuniteteve. Nëse krahasojmë strukturën e popullsisë që e shohim përditë në rrugët e qytetit të Prishtinës me ndonjë qytet tjetër në Evropë, do të shohim, se në rrugë, hapësirë publike, dyqane, zyra, etj., shohim shumë më pak persona me aftësi të kufizuara, por edhe një numër më të vogël të të moshuarve. Kjo nuk do të thotë që në strukturën tonë të popullsisë, këto komunitete janë në përbërje më të vogël. Kjo ndodh për shkak se numri i madh i barrierave fizike në qytet – apo në ndërtesat që i banojnë, në ndërtesat e shërbimeve dhe administratës lokale, në lokale shërbyese, etj. ua bën të pamundshme daljen nga shtëpia në mënyrë të pavarur, apo edhe pa përcjellje. Krahas këtyre, janë edhe barrierat institucionale, korniza ligjore e pakompletuar, mekanizma të munguar për implementimin e kuadrit ligjor ekzistues, që kontribuojnë në pamundësimin dhe vështirësimin e lëvizjes së pavarur dhe përfshirjes në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara.

Gjithsesi, qasja parësore që mund të ketë impakt të rëndësishëm në bërjen e qytetit më miqësor për të gjithë, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, është bërja e qytetit në bashkëpunim me të gjitha komunitetet të cilët e banojnë atë. Bashkëpunimi në bërjen e qytetit, nënkupton që në të gjitha diskutimet rreth planeve për qytetin duhet të përfshihet komuniteti përkrah ekspertëve, urbanistëve, arkitektëve, politikanëve dhe zyrtarëve të tjerë administrativ. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet një përfaqësim më i madh i kërkesave themelore të komuniteteve në planifikim të qyteteve.



Sot, bazuar në kuadrin ligjor ekzistues, interaktimi me komunitet në proces të planifikimit rregullohet përmes dispozitave që përcaktojnë numrin e diskutimeve publike të fazave të projektit që duhet të kryhen përpara se plani të validohet. Mirëpo, diskutimet publike, në mënyrën se si mbahen në Kosovë, nuk janë aspak formë e bashkëpunimit me komunitet në planifikim të qyteteve. Ato zakonisht mbahen në forma plenare, me një auditor të kufizuar, meqë format e lajmërimit që përdoren nga administrata lokale nuk janë efektive. Në takimet plenare, nga të pranishmit (me shumicë absolute të gjinisë mashkullore) pritët të dëgjohet ndonjë koment i izoluar mbi fazën finale të planit, i cili prezantohet në medime jo fort të kuptueshme për ta. Kështu, nuk mbërrihet as të merret ndonjë kërkesë apo nevojë specifike e komunitetët banues të zonës që planifikohet, por as ndonjë koment substancial rreth planit, i cili prezantohet para publikut. Me këtë planet, me ta marrë vizën e mbajtjes së diskutimit publik, shkojnë në kuvend dhe aprovohen. Ndoshta, kjo është një mënyrë shumë e thjeshtësuar e tregimit të procesit planifikues që kryhet në qytetet tona, por realiteti nuk është fare larg nga ky portretizim.

Dhe për pasojë të gjithë këtij procesi të planifikimit me shumë të meta, por edhe për shkak të kuadrin ligjor që nuk zbatohet mirë, si dhe mungesës së komunikimit me komunitet, e në veçanti me komunitet më të marginalizuara, vendbanimet tona dhe i gjithë mjedisi i ndërtuar mbetet problematik për nga mosfunksionimi i mirë i infrastrukturës, hapësirë publike jo funksionale, barrierat arkitektonike për komunitetët që kanë mobilitet të kufizuar, dhe në përgjithësi qytet përjashtuese më parë se sa gjithëpërfshirëse.

Punëtorja e vizionimit të Parkut të qytetit për të gjithë, ka për qëllim që të ofrojë zgjidhje për eliminimin e barrierave arkitektonike në parkun e qytetit të Prizrenit, për ofrimin e zgjidhjeve hapësinore, intervenimeve fizike që pjesë të caktuara rekreuese të parkut të jenë të qasshme për të rritur, të rinj dhe fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara. Por mbi të gjitha, kjo punëtorja mëton që të ofrojë një model të planifikimit dhe projektimit me komunitet, e në veçanti me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuar, me qëllim të identifikimit të problemeve, kërkesave dhe nevojave themelore për këto komunitete, si dhe për propozimin e aktiviteteve dhe programeve, nga e cila do të përfitonin ata si komunitet, por edhe të gjithë qytetarët. Qëllimi i punëtorisë, para së gjithash, është që përmes një procesi të planifikimit me komunitet, të ofrojë një zgjidhje për një park më të gjallëruar, nga i cili do të përfitojnë të gjithë në Prizren.

## 1. PUNËTORIA E VIZIONIMIT “PARKU I QYTETIT PËR TË GJITHË”

### 1.1. Përshkrimi i lokacionit



Punëtorja u organizua me qëllim të ndërtimit të vizionit për një park më të qasshëm dhe më të gjallëruar për të gjitha komunitetet. Lokacioni, i cili u trajtua në punëtorinë e vizionimit, është parku i qytetit në Prizren. Parku i qytetit të Prizrenit ka një mjedis me vegetacion shumë të pasur, kufizohet me Lumbardhin dhe shtrihet në një terren të pjerrtë. Parku gjendet ngjitur me kampusin universitar të Universitetit “Ukshin Hoti” dhe me stadiumin e qytetit “Përparim Thaçi”, ndërsa në kontekst më të gjerë parku gjendet pranë varrezave dhe spitalit të qytetit. Kampusi universitar si dhe lokacionet e lartpërmendura karakterizohen me gjelbërim të bollshëm. Andaj, nëse shihen në hartë, e gjelbra dominuese e kësaj pjese të qytetit, në kontekstin e qytetit, rri kundruall parkut të Marashit me kodrën e kalasë të ndara nga pjesa e vjetër dhe më vibrante e qytetit. Parku i Marashit, shfrytëzohet jashtëzakonisht shumë nga të gjithë qytetarët, kryesisht për rekreacion. Ai është destinacion i gjithë qytetarëve të qytetit, pavarësisht distancës nga shtëpia. Në veçanti shfrytëzohet gjatë mëngjeseve të hershme dhe mbrëmjeve të verës, nga popullata e moshuar. Por edhe dimrit nuk mungojnë qytetarë të

cilët e frekuentojnë me ëndje. Në anën tjetër, parku i qytetit të Prizrenit, që për nga përmasat është shumë më i vogël, por për nga cilësitë mjedisore mund të krahasohet me Parkun e Marashit, nuk frekuentohet aq shumë. Qytetarët e paktë që e frekuentojnë janë kryesisht banorët e lagjes së afërt. Arsyja pse ata e frekuentojnë është hija dhe gjelbërimi në të. Parku shërben edhe si hapësirë kalimtare për të rinjtë të cilët shkojnë në mësim në universitet. Por në përgjithësi, për nga pamja, parku duket si i lënë pasdore, me gjelbërim të pa mirëmbajtur, me mbeturina, mobiluar dhe lodra të dëmtuara. Me një fjalë, problemet kryesore të parkut lidhen me menaxhimin e keq të tij. Për shkak të një gjendjeje të tillë, gjithnjë e më shumë në të shihen persona që merren me aktivitete të dyshimta, dhe për shkak të cilëve, parku frekuentohet edhe më pak. Në përgjithësi, problemet janë të shumta, duke u nisur nga problemet fizike deri te ato programore, të cilat e bëjnë parkun e paqasshëm për të gjithë qytetarët.



Shkas për të trajtuar këtë park brenda një vizioni për gjallërim dhe qasje më të madhe për qytetarë, janë edhe barrierat e shumta fizike për grupet e personave me aftësi të kufizuara. Janë të shumta pengesat që paraqiten në park për persona me aftësi të kufizuara. Ka vende ku shtigjet janë shumë të pjerrtë, për shkak të terrenit të pjerrtë, mungojnë parkingjet për persona me aftësi të kufizuara, tualetet, ulëset janë të pa përshtatshme, mungojnë vijat taktore për të verbrit, shenjzimet për persona me aftësi të kufizuara, lodra dhe elemente të fituesit që mund të përdoren nga të gjithë, etj.

## 1.2. Qëllimet e punëtorisë së vizionimit

Punëtorja e vizionimit të Parkut të qytetit për të gjithë, ka për qëllim që të ofrojë zgjidhje për eliminimin e barrierave arkitektonike në parkun e qytetit të Prizrenit, për ofrimin e zgjidhjeve hapësinore, intervenimeve fizike që pjesë të caktuara rekreuese të parkut të jenë të qasshme për të rritur, të rinj dhe fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara. Por mbi të gjitha, kjo punëtori mëton që të ofrojë një model të planifikimit dhe projektimit me komunitet, e në veçanti me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuar, me qëllim të identifikimit të problemeve, kërkesave dhe nevojave

themelore për këto komunitete, si dhe për propozimin e aktiviteteve dhe programeve, nga e cila do të përfitonin ata si komunitet, por edhe të gjithë qytetarët. Qëllimi i punëtorisë, para së gjithash, është që përmes një procesi të planifikimit me komunitet, të ofrojë një zgjidhje për një park më të gjallëruar, nga i cili do të përfitojnë të gjithë në Prizren.

Punëtorja e vizionimit për parkun e qytetit të Prizrenit u realizua në dy faza takimesh. Takimi i parë u mbajt më 18 gusht, me ç'rast me komunitetin e pranishëm u punua për identifikimin e problemeve dhe kërkesave të komunitetit, si dhe në dhënien e propozimeve për arritjen e qasjes më të madhe në park për personat me aftësi të kufizuara dhe për të moshuar, por edhe për programin e aktiviteteve që do ta gjallëronin, do ta bënin më të shfrytëzueshëm dhe më të sigurt për të gjithë. Në fazën e dytë të procesit planifikues, pas një faze planifikimi, ku ne si arkitektë përmes ekspertizës sonë profesionale jemi përpjekur t'i përkthejmë problemet e identifikuara dhe propozimet e dala nga punëtorja e 18 gushtit, në intervenime fizike në mjedis të ndërtuar, në dizajnin e mjedisit të ndërtuar që do të përmirësonin qasjen e personave me aftësi të kufizuara, por edhe të qytetarëve të tjerë, në mes të shtatorit u bë prezantimi i draftit të vizionimit para një pjese të komunitetit pjesëmarrës në punëtori, për të marrë komentet, vërejtjet dhe rekomandimet në lidhje me punën tonë. Pas kësaj faze, me komentet e komunitetit mbi draftin e projektit, puna vazhdoi drejt përfundimit të versionit final të vizionit për parkun e qytetit të Prizrenit për të gjithë.

### 1.3. Materialet e punëtorisë

Me qëllim të realizimit të punës me komunitet gjatë punëtorisë së vizionimit, materialet vijuese ishin në dispozicion:

- Harta e lokacionit në kontekst të gjerë të Prizrenit
- Harta e lokacionit – gjendja ekzistuese në parkun e qytetit të Prizrenit
- Fotografi të disa barrierave fizike të identifikuara gjatë vizitës paraprake të ekipit në park
- Fotografi – shembuj të zgjidhjeve të ndryshme për eliminimin e barrierave arkitektonike në Evropë dhe SHBA
- Pyetësori

### 1.4. Komuniteti i përfshirë në punëtori

Në punëtorinë e vizionimit pjesëmarrës ishin si vijon:

- komuniteti i personave me aftësi të kufizuara

6

- komuniteti i pensionistëve
- disa të rinj përcjellës të personave me aftësi të kufizuara
- personeli i EC Ma Ndryshe dhe i OPDMK

## 1.5. Metodologjia e punës

### 1.5.1. Faza përgatitore e punëtorisë

- Analiza paraprake e pozitës së lokacionit në qytetin e Prizrenit si dhe e lokacionit të ngushtë parkut të qytetit. Kjo fazë u krye në fillim të gushtit brenda dy vizitave gjithë ditore në parkun e qytetit, si dhe përmes analizës së hartave të qytetit të Prizrenit. Po ashtu, gjatë kësaj vizite u evidentuan problemet kryesore infrastrukturore, të hapësirave ekzistuese të aktiviteteve si dhe të pajisjeve që gjendeshin në park.



- Analiza paraprake e problemeve të qasjes për personave me aftësi të kufizuara në brendi të parkut. Kjo fazë u realizua në një vizitë prej disa orësh parkut në shoqëri të dy pjesëtareve të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Gjatë kësaj vizite, u evidentuan konkretisht problemet themelore të qasjes për personat me aftësi të kufizuara, në veçanti për përdorues karrocash mekanike dhe elektrike, si dhe për persona të verbër. Me problemet dhe situatën e evidentuar në terren, u përgatitën hartat dhe fotografitë si material bazë për realizimin e punëtorisë së vizionimit më 18 gusht.



### 1.5.2. Realizimi i punëtorisë

Në punëtorinë e vizionimit, fillimisht në një bisedë të lirë gjysmë orësh pjesëmarrësit shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me barrierat fizike që i hasin në qytetin e Prizrenit përditë. U theksua që vazhdojnë të jenë vështirë të qasshme shumë institucione, por edhe infrastruktura në qytet me

trotuaret e zaptuara si dhe transporti publik me autobus të paqasshëm, e bëjnë shumë problematike gjithë lëvizjen në qytet për këtë komunitet.



Në pjesën vijuese të punëtorisë, pjesëmarrësit patën rast t'i përgjigjeshin pyetësorit, përmes të cilit mëtohej që të identifikoheshin disa nga problemet kyçe të qasjes për persona me aftësi të kufizuara por edhe për komunitetet e tjera në parkun e qytetit të Prizrenit. Po ashtu, me këtë mjet, u tentua që të nxirreshin arsyet për frekuencën e vizitave në park, dhe arsyeve për mosvizita. Rezultatet e anketës janë të përmbledhura më poshtë në këtë raport.



Me të përfunduar pjesa e anketimit, pjesëmarrësit u ndanë në grupe dhe përmes fasilitatorëve, në hartat tashmë të përgatitura nga grupi i ekspertëve fillimisht identifikonin vendet problematike, dhe pastaj përmes fotografive udhëzuese, por edhe diskutimit të shembujve për të cilët tashmë ishin në dijeni, qoftë nga mjetet e informimit, mediat sociale apo nga vizitat në Evropë, u përmbledhën propozimet për përmirësimin e qasjes për persona me aftësi të kufizuara, si dhe për aktivitete që do të gjallëronin si dhe do të ftonin më shumë qytetarë në park.

Pas rekapitullimit të punëtorisë, me të dhënat e mbledhura dhe bazuar në analizat dhe hulumtimet në terren dhe të praktikave të mira nga Evropa, ekipi hartoi një draft të vizionit për parkun e qytetit të Prizrenit. Një muaj pas mbajtjes së punëtorisë, këtë draft ekipi projektues ia prezantoi një pjesë të pjesëmarrësve të punëtorisë nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, në një takim që u mbajt në zyrat e objektit të Beledijes në Prizren. Pas prezantimit, pjesëmarrësit, dhanë komentet dhe vërejtjet, dhe rekomandimet e tyre. Me këto të fundit, ekipi projektues finalizoi projektin e vizionimit të parkut të qytetit të Prizrenit si një *park për të gjithë, i cili ofron mundësi rekreimi, argëtimi dhe relaksimi të gjithë qytetarëve pa dallim gjinie, moshe, aftësie a situatë ekonomike.*





## 2. REZULTATET NGA PUNËTORIA

### 2.1. Rezultatet e anketimit gjatë punëtorisë së vizionimit “PARKU I QYTETIT TË PRIZRENIT PËR TË GJITHË”

Anketimi u realizua në fillim të punëtorisë. Anketimit iu nënshtruan gjithsej 22 persona. Anketimi u realizua rreth 30 minuta dhe atij iu nënshtruan pos komunitetit pjesëmarrës në punëtori, përcjellësit e personave me aftësi të kufizuara si dhe personeli i EC Ma Ndryshe dhe OPDMK-së. Më poshtë po e japin një mostër të pyetësorit.

#### PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E QASJES DHE SHFRYTËZIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT

##### 1. A E VIZITONI PARKUN E QYTETIT NË PRIZREN?

- a. Po
- b. Jo

##### 2. PSE E VIZITONI/ SHFRYTËZONI PARKUN E QYTETIT NË PRIZREN?

- a. Relaksim/ për të marrë ajër të pastër
- b. Ushtrime fizike
- c. Për të shëtitur qenin
- d. Vizitë me miq/ familje/ fëmijë
- e. Luaj/ shikoj sport a lojëra
- f. Vrapim
- g. Të shfrytezoj hapësirën për lojëra fëmijësh
- h. Vizita të organizuara educative
- i. Të ngas biçikletën
- j. Të shijoj natyrën/ gjelbërimin
- k. Për të pirë kafe/ pije në lokal
- l. Për të lexuar
- m. Tjetër

##### 3. NËSE NUK E VIZITONI PARKUN E QYTETIT, CILA ËSHTË ARSYEJA?

- a. Prania e personave dhe grupeve të dyshimtë
- b. Pajisjet e lojës së fëmijëve/ të rekreacionit janë në gjendje të keqe
- c. Menaxhimi i dobët i parkut (mbeturina, shtigje të dëmtuara, gjelbërimi i pamirëmbajtur, ndriçimi i munguar natën, etj.)
- d. Nuk ka qasje ose qasje është e vështirë (shtigjet e paqasshme, sipërfaqet e dëmtuara, etj.)
- e. Nuk ka tualete publike
- f. Personat që shëtisin qenë të palidhur
- g. Tjetër

##### 4. CILAT NGJARJE, AKTIVITETET DO TA PËRMIRËSONIN PËRJETIMIN TUAJ TË PARKUT, APO DO T'JU BËNIN TA VIZITONI PARKUN MË SHPESH?

- a. Më shumë aktivitete sportive për të gjithë
- b. Aktivitete të organizuara për fëmijë/ familje
- c. Më shumë muzikë të gjallë nga grupe apo muzikantë lokalë, etj.
- d. Aktivitete tematike me temë mjedisin, botën shtazore/ bimore (aktivitete për familje, fëmijë, ekspedita për hulumtim/ njohje të mjedisit, etj.)
- e. Organizimi i festimit të festave të ndryshme për të gjithë (festat kombëtare, etj.)
- f. Vizita, diskutime me guida të specializuar
- g. Dizajnimi i veprave të artit publik
- h. Aktivitete arkistike dhe praktike për komunitetin
- i. Shfrytëzimi i parkut për qëllime edukative nga shkollat
- j. Aktivitete sportive dhe rekreative për të gjithë (ushtrime kineze Tai Chi, ecje rekreative, etj.)
5. Ju lutem shënoni edhe ndonjë aktivitet/ ngjarje tjetër që do të donit të shihni në park.

**6. CILAT INTERVENIME FIZIKE NË PARK DO T'JUA PËRMIRËSONIN PËRJETIMIN E PARKUT APO DO T'JU BËNIN TA VIZITONIT MË SHPESH? (rretho më shumë se një përgjigje)**

- a. Parkimi për P.A.K.
- b. Rregullimi i shtigjeve për shfrytëzim për persona me karroca, të verbër dhe me shikim të dobësuar (zgjerimi, shtrimi i shiritave taktorë, evidentimi i skajeve me ngjyra kontrastuese)
- c. Fushat e lojës për fëmijë të jenë të projektuara për shfrytëzim nga të gjithë
- d. Fushat e sportit të jenë të dizajnuara për shfrytëzim nga të gjithë
- e. Ulëset në park të jenë të përshtatshme për të gjithë
- f. Sipërfaqet për piknik të kenë mundësi qasjeje me karrocë (tavolinat, pozita e bankave, të lejojnë qasjen me karrocë, etj.)
- g. Lule me ngjyra të forta kontrastuese përgjatë shtigjeve (që të krijojnë skaje të shtigjeve më lehtë të dallueshme, etj.)
- h. Lule dhe bimësi aromatike përgjatë shtigjeve (për të përmirësuar përjetimin shqisor të parkut, për të orientuar në lëvizje në park, etj.)
- i. Hartë taktore orientuese, me informata të tjera rreth parkut për orientim të personave të verbër
- j. Fontana me ujë të pijshëm (fontana të qasshme)
- k. Tualete publike për të gjithë në park
- l. Ndrichim i mirë gjatë mbrëmjeve
- m. Qasje me transport publik
- n. Rregullimi i qasjes në rrugë dhe trotuare që çojnë deri te parku (zgjerim trotuaresh, rregullim i sipërfaqeve të dëmtuara, heqja e makinave të parkuara, mallit dhe reklamave të shitoreve, shtrimi i trotuareve me vija taktore, etj.)
- o. Tjetër (të lutem shëno më poshtë)

**7. MOSHA JUAJ**

**8. GJINIA**


- a. M
- b. F

**9. A JENI PERSON ME AFTËSI TË KUFIZUAR?**


- a. Po
- b. Jo
- c. Preferoj mos të deklarohe

**10. JU LUTEM TREGONI CILAT JANË PROBLEMET E PARKUT QË JUA PAMUNDËSOJNË APO VËSHTIRËSOJNË QASJEN NË TË**


1. Pjesëmarrësit e ndarë sipas gjinisë




## 2. Pjesëmarrësit të ndarë sipas përfaqësimit të komunitetit



## 3. Pjesëmarrësit e ndarë sipas moshës




## 4. Pjesëmarrësit me aftësi të kufizuara të ndarë sipas gjinisë



Femra të anketuara janë gjithsej 5. Prej tyre tre persona janë të moshës 30-39 vjeçare, një grua e moshës 40 vjeçare dhe 1 person nuk e ka deklaruar moshën. Ndërsa meshkuj të anketuar janë gjithsej 8, tre prej tyre janë të moshës 16-19 vjeçare, dy persona të moshës 20-29 vjeçare, një person i moshës 40 vjeçare dhe një person 50 vjeçar.

## 5. Pjesëmarrësit e tjerë të ndarë sipas gjinisë




Femra të anketuara janë gjithsej 4. Prej tyre një grua e moshës 40 vjeçare, një grua e moshës 20 vjeçare dhe 2 gra të moshës mbi 65 vjeçare. Ndërsa meshkuj të anketuar janë gjithsej 4, një prej tyre 20 vjeçar, një person i moshës 30 vjeçare, dy persona të moshës mbi 65 vjeçare.

Përgjigjet në pyetjet e anketës

*Pjesëmarrësit të gjinisë mashkullore*


## 6. A e vizitoni parkun e qytetit të Prizrenit dhe për cila arsye?

*Arsyet për vizitë për pjesëmarrësit meshkuj janë:*




Në përgjithësi, parku frekuentohet më shumë prej të rinjve meshkuj, ndërsa parku nuk frekuentohet shpesh ose fare nga meshkujt e moshës së mesme.

Arsyet për mosvizitë për pjesëmarrësit meshkuj janë:




7. Cilat ngjarje, aktivitete do ta përmirësonin përjetimin e parkut, apo do t'ju bënin që ta vizitoni atë?



Në total, aktivitetet që do të bënin personat e tjerë që të frekuentonin më shumë parkun e qytetit listohen si vijon:

8. Cilat intervenime fizike në park do t'ju përmirësonin përjetimin e parkut, apo do t'ju bënin që ta vizitoni atë?




9. Komente në lidhje me problemet kryesore

- Qentë endacakë; mirëmbajtja jo e mirë e parkut (mbeturinat e grumbulluara, etj.)
- Komunikacioni i rënduar përreth parkut,
- hyrjet në park të pasiguruara, si dhe në përgjithësi siguri e munguar në park, etj.
- Pasiguria për shkak të pranisë së personave të dyshimtë në park,
- Rruga deri te parku e paqasshme për komunitetin PAK (trotuaret e paqasshme ose vështirë të qasshme),
- mungesa e transportit publik,
- mungesa e tualeteve publike për PAK;
- mungesa e informimit;
- gjelbërimi i paktë ose i munguar në rrugët e qytetit që çojnë në parkun e qytetit.

*Pjesëmarrëset e gjinisë femërore*


10. A e vizitoni parkun e qytetit të Prizrenit dhe për cila arsye?

\*Asnjë grua nga pjesëmarrëset e intervistuar që nuk i përkiste komunitetit PAK nuk e viziton parkun e qytetit të Prizrenit.



Gratë nga komuniteti PAK në numër shumë të vogël e vizitojnë në raste shumë të rralla parkun dhe atë për relaksim/ për të marrë ajër të pastër dhe në vizitë me miq/ familje/ fëmijë.

11. Cilat intervenime fizike në park do t’jua përmirësonin përjetimin e parkut, apo do t’ju bënin që ta vizitoni atë?



12. Cilat ngjarje, aktivitete do ta përmirësonin përjetimin e parkut, apo do t'ju bënin që ta vizitoni atë?

Në total, aktivitetet që do të bënin personat e tjerë që të frekuentonin më shumë parkun e qytetit listohen si vijon:

- Më shumë aktivitete sportive dhe rekreative për të gjithë
- Aktivitete të organizuara për fëmijë/ familje
- Vizita, diskutime dhe guida të specializuara
- Më shumë muzikë të gjallë nga grupe apo muzikantë lokalë
- Dizajnim i veprave të artit publik
- Aktivitete tematike me temë mjedisin, botën shtazore/ bimore (aktivitete për familje fëmijë, ekspedita për hulumtim/ njohje të mjedisit, etj.)
- Aktivitete artistike dhe praktike për komunitetin
- Organizimi i festave të ndryshme për të gjithë (p.sh. festave kombëtare, etj.)

13. Komente në lidhje me problemet kryesore nga pjesëmarrëset gra

- Pasiguria,
- mungesa e tualeteve,
- mbeturinat e shumta në park
- prania e narkomanëve, qen të shumtë endacakë,
- pamundësia e shfrytëzimit të parkut për shkak të largësisë nga shtëpia;
- komunikacioni shumë i dendur në rrugët e qytetit që çojnë për në park,
- pjerrinat në park në nivel dhe pjerrësi jo të përshtatshme
- shkallëve u mungojnë rrethojat për mbajtje, etj.

*Konkluzion: Nga anketimi i komunitetit pjesëmarrës gjatë mbajtjes së punëtorisë së vizionimit për parkun e qytetit të Prizrenit u evidentuan një sërë problemesh, për shkak të cilave, shumica e pjesëmarrësve nuk e vizitojnë shpesh ose fare parkun. Problemi kryesor paraqitet largësia dhe pamundësia e qasjes në park për shkak të autobusëve të paqashtëm dhe trotuareve të qytetit që kanë shumë barriera. Po ashtu, për*



*shkak se parkut i mungojnë aktivitete që ta gjallërojnë në të si dhe infrastruktura por edhe vegjetacioni i pa mirëmbajtur, shumë pjesëmarrës e evitojnë parkun e qytetit. Për më shumë, menaxhimi i mangët apo jo i mirë i tij, bën që ai të frekuentohet nga persona dhe grupe të dyshimtë që ngacmojnë, dhe e bëjnë që gjinia femërore në veçanti të ndihet e pasigurt. Ndjenjës së pasigurisë i kontribuon edhe ndriçimi i munguar i mbrëmjes, por edhe mosmirëmbajtja e vegjetacionit. Aktualisht, zona më aktive e parkut është ajo e cila gjendet me e zbuluar nga vegjetacioni, dhe që është fare pranë “nën vëzhgim” të bllokut banesorë që gjendet mëtanë lumit. Për komunitetin PAK, arsyet për mosvizitë janë edhe barrierat fizike përbrenda parkut (shtigjet me pjerrtësi të pakapërcyeshme; sipërfaqet e shtigjeve të dëmtuara; mungesa e vijave dhe fushave taktore për të udhëzuar lëvizjen e të verbërve; tualetet e munguara për PAK; mungesa e pajisjeve të fituesit dhe të lojërave për të rriturit dhe fëmijët e komunitetit PAK, etj.*

*Nga ajo që u tha më lartë mund të përfundojmë se me qëllim të gjallërimit të parkut të qytetit dhe sjelljes së qytetarëve të të gjitha moshave, pa dallim gjinie, aftësie apo shtate ekonomike në park (pavarësisht largësisë së vendbanimit, duhet ndërmarrë masa të përmirësimit infrastrukturor jashtë dhe brenda parkut; pajisje me mjete gjithëpërfshirëse për lojë dhe sport; duhet hartuar një program të ngjeshur aktiviteteve, të llojeve të ndryshme, për stinë të ndryshme; duhet rritur sigurinë me përmirësimin e ndriçimit, menaxhimit më të mirë të parkut (largimi i mbeturinave, mirëmbajtja e gjelbërimit, shpërndarja e aktiviteteve të ndryshme në pjesë të ndryshme të parkut, që të sigurohet gjithmonë prani e njerëzve, etj.).*

*Me këto intervenime, do të sigurohej që cilësitë kryesore mjedisore të parkut të qytetit, hija, dielli, gjelbërimi, loja, qetësia e rekreimi, do të mund të gëzoheshin nga të gjithë qytetarët pa dallim.*

## **2.2. PROPOZIMET E DALA NGA PUNA ME KOMUNITET GJATË PUNËTORISË SË VIZIONIMIT**

2.2.1. Rregullimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara nga qyteti i Prizrenit për në parkun e qytetit të Prizrenit

2.2.1.1. Transporti publik

- Përcaktimi i stacionit të autobusit urban
- Rregullimi i linjave të transportit urban
- Autobusët të jenë qasshëm për komunitetin PAK - përdorues karrocash, prindër me karroca fëmijësh, etj.
- Transporti publik të jetë pa pagesë për komunitetin PAK dhe për të moshuarit



#### 2.2.1.2. Rregullimi i qasjes për PAK në rrugët këmbësorike prej qytetit deri në park të qytetit

- Zgjerim i trotuareve në qytet
- Rregullimi i sipërfaqeve të trotuareve dhe kubëzave në vendet ku janë të dëmtuara në rrugët e qytetit
- Rregullimi/ vendosja e pjerrinave në trotuare te vendkalimet këmbësorike
- Vendosja e vijave dhe fushave taktore në trotuare (konform UA 33/2007)
- Eliminimi i barrierave të ndryshme që paraqiten gjatë rrugëtimit për në park (lirimi i trotuareve nga malli i ekspozuar, mobiliari i kafeneve, reklamave, automjeteve të parkuara, etj.)

#### 2.2.1.3. Rregullimi i hyrjeve në park dhe shenjzimi qasës

- Eliminimi i pragjeve të hyrjet, etj.
- Sigurimi i hyrjeve
- Vendosja e planit orientues për persona të verbër te hyrjet e parkut
- Vendosja e një/ dy info-pikave në afërsi të hyrjeve të parkut

- Vendosja e shenjave qasëse
- Përmirësimi i rampës në urën mbi lumin Lumbardh për të mundësuar qasjen për përdorues karrocash dhe të prindërve me karroca fëmijësh, si dhe vendosja e vijave dhe fushave taktore në dhe në afërsi të urës.
- Ndërlidhja e hapësirës së parkut të qytetit me hapësirën e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”
- Ndërlidhja e parkut me stadiumin “Përparim Thaçi” dhe me fushën e gjelbër që gjendet përbri parkut.<sup>1</sup>

#### 2.2.1.4. Rregullimi i parkingjeve

- Rregullimi i parkingjeve ekzistuese pranë hyrjes perëndimore si dhe gjetja e një sipërfaqeje shtesë pranë parkut për parkim të automjeteve
- Shtimi i një sipërfaqeje të parkingut për PAK në secilin nga këto parkingje të propozuara



#### 2.2.2. Rregullimi i qasjes për PAK përbrenda parkut

##### 2.2.2.1. Eliminimi i barrierave arkitektonike

- Eliminimi i “pragjeve” te kryqëzimet e shtigjeve të parkut
- Eliminimi i “pragjeve” ndërmjet shtigjeve dhe dyshemesë të gazebot (strehët për piknik)
- Eliminimi i pragjeve në qasjen drejt ndërtesës së tualetit kryesor

*1. Në këtë pike shumica e pjesëmarrësve u dakordua, që stadium kryesor i Prizrenit të zhvendosej diku në periferi të qytetit, ndërsa stadiumi aktual, bashkë me sipërfaqen rrethuese, të jenë pjesë e përbërëse e zones së parkut, dhe si sipërfaqe sportive të jetë në shërbim të komunitetit.*


### 2.2.2.2. Rregullimi i sipërfaqes së shtigjeve

- Rregullimi i kubëzave në shtigje, rrafshimi i i gropave në shtigje, etj.
- Vendosja e rrethojave për lehtësim të qasjes në shkallë dhe në shtigjet më të pjerrëta.
- Rrethojat duhet të jenë të standardeve që përshkruhen për qasjen e PAK (UA 33/2007)
- Zbutja e pjerrtësisë së shtegut aty ku është e mundshme dhe e domosdoshme për të pasur qasje të plotë në park.<sup>2</sup>



### 2.2.2.3. Rregullimi i qasjes për persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar

- Fusha dhe vija taktore përgjatë shtigjeve



- Krijimi i skajit të shtigjeve përmes mbjelljes së luleve me ngjyra kontraktuese për të ndihmuar orientimin e personave me shikim të dobësuar.


2. Në disa vende zbutja e pjerrtësisë nënkupton intervenime inxhinierike të shumta që do të rritnin shumë koston e intervenimit. Një nga format më pak të kushtueshme të propozuara ishte intervenimi me struktura të drunjta që, sipër shtigjeve ekzistuese do ta ngritnin shtegun me qëllim të zbutjes së pjerrtësisë. Por gjithsesi duhet pasur kujdes që intervenimet e reja të mos krijojnë barriera të reja për lëvizjen e qytetarëve.



- Vijat dhe fushat taktore të kenë ngjyrë kontraktuese me ngjyrën e përgjithshme të dyshemesë, për të ndihmuar lëvizjen nëpër shtigje për persona me shikim të dëmtuar.
- Të vendosen shenjëzimet e drejtimit në park në gjuhën Braille



- Të vendoset plani orientues në një/ dy vende te hyrjet e parkut



### 2.2.3. Përmirësimi dhe adaptimi i ndërtesave ndihmëse në parkun e qytetit për të qenë më të qashme për të gjithë

#### 2.2.3.1. Tualetet

- Te ndërtesa e kafenesë, të riprojektohet hapësira ekzistuese e tualeteve dhe e depos në tualete të ndara në gjini me hyrje të veçanta dhe një tualet për PAK
- Të modifikohet ndërtesa ekzistuese e tualeteve publike dhe të shtohet një tualet për PAK dhe një hapësirë tjetër për ndërrimin e foshnjave.



- Të zgjerohen të gjitha dyert konform përmasave të përcaktuara për dyer të qashme në tualete sipas UA 55/2007).
- Të eliminohen pragjet, si dhe të vendosen sipërfaqe të pjerrinave aty ku nevojiten për të kapërcyer disnivelin.
- Të vendosen shenjzimet qasëse
- Të punohet kulmi i gjelbër

#### 2.2.3.2. Ndërtesa e kafenesë

- Të rregullohet qasja te hyrjet në ndërtesë (eliminim i pragjeve dhe vendosja e pjerrinave të vogla)
- Të projektohet enterier pa disnivelin
- Të projektohet enterieri i lokalit asisoj që të ketë hapësirë të mjaftueshme për lëvizje me karrocë
- Sipërfaqja e terracës të jetë e shtruar me dysheme të qashme <sup>3</sup>

3. Aktualisht, tavolinat e terraces janë të vendosura në bar/dhe.

- Të vendoset mobiluar i qasshëm për përdorues karrocash në tarracë



- Të vendosen shenjzimet qasëse
- Të punohet kulmi i gjelbër

#### 2.3.3.3. Amfiteatri

- Rregullimi i qasjes deri te amfiteatri
- Përshtatja e objektit (qasja në tribuna; zgjerimi i tribunave, etj.) për të qenë më të shfrytëzueshme edhe nga komuniteti PAK.

#### 2.3.3.4. Gazebot (strehët për piknik)

- Të përmirësohet qasja për PAK deri te strehët
- Të bëhet redistribuimi i tyre në hapësirën e parkut
- Të ridizajnohet struktura e gazebos, me materiale natyrore <sup>4</sup>
- Pranë secilës strukturë të shtohen vendet për skarë
- Mobiluar i strehës të jetë i qasshëm PAK

4. Gazebot mund të kenë kulm të gjelbër për t'u harmonizuar me mjedisin.

## 2.3.3.5. Kroje për ujë të pijshëm

- Të vendosen në disa pika të parkut fontana (kroje) me ujë të pijshëm. Të gjitha fontanat të dizajnohen që të jenë të qasshme edhe për përdorues karrocash



## 2.3.3.6 Sipërfaqet dhe pajisjet e lojërave për fëmijë

- Të gjitha këndet për lojëra për fëmijë të jenë të qasshme për të gjithë<sup>5</sup>



5. Pajisjet të jenë njësoj të shfrytëzueshme si për fëmijë persona me aftësi të kufizuara ashtu edhe fëmijë të tjerë.



- Të vendoset një kënd i lojës me rërë, i cili duhet të jetë i qasshëm edhe për fëmijë nga komuniteti PAK



- Të vendoset një kënd i lojës me baltë (skulpturë) <sup>6</sup>

#### 2.3.3.6. Fushat e sportit


- Të gjitha fushat e sportit të jenë të qasshme për të gjithë
- Fushë multifunkionale për shumë lojëra



- Të ridizajnohet sipërfaqja e fitnesit dhe t'i jepen përmasat dhe pajisjet që mund të përdoren nga të gjithë.<sup>7</sup>



- Ndërtimi i poligonit në të cilin përdoruesit e karrocave (përfshi edhe fëmijët) do të mund të ushtronin. Pos tyre, këtë poligon për ushtrime, do të mund ta përdornin edhe çiklistë dhe skejterë.



#### 2.3.3.7. Ulëset (bankat)

- Të vendosen ulëse të llojeve të ndryshme (ulëse fikse, karrige, banka, etj.) me qëllim të dhënies së një varieteti më të gjerë të relaksimit në park (individualisht apo ne grupe)

*7. Ekzistojnë pajisje të fitnesit që mund të përdoren nga komuniteti PAK dhe qytetarët e tjerë.*



- Ulëset të jenë të qasshme për persona shtatshkurtër (të kenë mbajtëse që ndihmojnë në ulje në bankë)
- Sipërfaqe pranë ulëseve të zgjerohen dhe të mundësohet pranë tyre qëndrimi i pjesëtarëve të komunitetit PAK – përdorues karrocash, por edhe e prindërve që shëtisin fëmijët me karroca.
- Të sigurohen grupe vendesh për ulje nën hije.

#### 2.3.3.8. Hortikultura

- Saksi të përmasave të ndryshme (të lartësive të ndryshme) me lule dhe bimësi, për aktivitetet e hortikulturës për qytetarë <sup>8</sup>



8. Gjatë diskutimi me komunitetin, disa here u theksua aktiviteti i hortikultures, si një nga aktivitetet që qytetarët do të donin ta ushtronin në hapësirën e parkut të qytetit.

#### 2.2.4. Ndriçimi

- Të rregullohet ndriçimi në të gjithë parkun. Të vendosen poçet aty ku mungojnë; të vendosen shtyllat aty ku janë dëmtuar apo larguar.
- Të sigurohet ndriçim me poçe ekonomike.

#### 2.2.5. Mirëmbajtja

- Të sigurohet mirëmbajtja e gjelbërimit (e cila mund të bëhet nga kompania që do ta menaxhojë parkun, apo me organizim të komunitetit).
- Të vendosen shportat e mbeturinave të ndara për materiale të ndryshme, me qëllim të promovimit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave.



- Të pastrohet dhe të mirëmbahet lumi.
- Të mirëmbahet mobiliari në park (të riparohen ulëset e dëmtuara; të lyhen me ngjyra mbrojtëse, etj.)
- Të mirëmbahen pajisjet e lojërave për fëmijë dhe ato të fitnesit në ajër të hapur.
- Të mirëmbahen shtigjet e ecjes në park (të riparohen sipërfaqet e dëmtuara).
- Të mirëmbahen fushat e sportit.
- Të sigurohet një depo për pajisje dhe inventar të lojërave, si dhe për mjetet e mirëmbajtjes së gjelbërimit dhe pastrimit të parkut.

### 2.2.6. Të tjera

- Të vendosen në disa vende në park priza elektrike, në të cilat personat që përdorin karroca elektrike do të kenë mundësi që të mbushin baterinë e karrocës.
- Të sigurohet Wi Fi në park.
- Të vendosen shtëpiza për zogj.

### 2.2.7. Programi i aktiviteteve në park, i kërkuara nga komuniteti

- Gjatë disa ditëve në javë, apo në fundjava, të ketë programe me muzikë e lehtë nga grupe të qytetit, të cilët do të loznin në disa pika të parkut.



- Teatër në ajër të hapur
- Aktivitetet hortikulturore (si aktivitete për të gjitha moshat) <sup>9</sup>
- Ushtrime në ajër të pastër (Joga, Tai chi, pilates, etj.)





- Të krijohet program i aktiviteteve sportive për të gjithë
- Të krijohet një program i aktiviteteve edukative për fëmijë dhe të rinj (njohja me florën dhe faunën e parkut; aktivitetet e hortikulturës; aktivitetet e edukatës fizike në të hapur, etj.)
- Të ofrohen mundësi dhe vende për organizimin e piknikëve familjare,
- Festimi i festave kombëtare dhe të tjera në hapësirën e parkut, etj.


*Konkluzion: Gjatë punës në grupe në punëtori, me ndihmën profesionale të fasilitatorëve që janë arkitektët e ekipit projektues, dhe duke u bazuar në shembuj frymëzues nga Evropa dhe SHBA, nga njohuria e përgjithshme apo vizitat që janë bërë jashtë vendit, komuniteti propozoi intervenimet dhe aktivitetet e mësipërme, që do t'ia kthenin vitalitetin parkut. Fillimisht propozimet kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve kryesore të qasjes për persona me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe qytetarëve të tjerë, pastaj rekomandohet pajisja e parkut me mjete gjithëpërfshirëse për lojë e rekreim, program aktivitetesh, si dhe menaxhimin e mirëmbajtjes më të mirë të tij, në mënyrë që qytetarët të ndihen të sigurt në të dhe të kenë arsye të vijnë në park. Problemet e evidentuara gjatë anketimit si dhe propozimet e komunitetit gjatë punëtorisë, të komplementura me analizën paraprake të lokacionit, problemeve hapësinore, infrastrukturore dhe të përmbajtjes programore të parkut, të bëra nga ekipi projektues, e përvijuan konceptin e vizionit për parkun e qytetit si park gjithëpërfshirës, dhe ndihmuan në ndërtimin e rekomandimeve dhe dizajnimin e intervenimeve në park.*

### 3. VIZIONI I PARKUT TË QYTETIT PËR TË GJITHË

#### 3.1. Identifikimi i barrierave fizike dhe problemeve të tjera në parkun e qytetit të Prizrenit

Gjatë disa vizitave që i kemi bërë parkut të Prizrenit, i kemi evidentuar problemet dhe barrierat fizike për qasje për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara si vijon:


##### 3.1.1. Barrierat fizike në rrugët e qytetit që çojnë drejt parkut të qytetit <sup>10</sup>



10. Barrierat fizike që pengojnë qasjen e komunitetit PAK të evidentuara në rrugët që çojnë drejt parkut janë gjithandej qytetit të Prizrenit. Andaj rekomandimet për largimin e këtyre barrierave në fakt duhet të zbatohen në gjithë qytetin e Prizrenit.



### 3.1.2. Hyrjet në parkun e qytetit






## 3.1.3. Shtigjet në park



## 3.1.3.1. Pengesa (pragje) ndërmjet shtigjeve



### 3.1.3.2. Shtigjet e pjerrëta



### 3.1.4 Shkallët në park



3.1.5. Tualetet në kafene (1) dhe në objektin e veçantë (2)




3.1.6. Ulëset (Bankat)



3.1.7. Pajisjet e lojës për fëmijë, pajisjet e fituesit dhe fushat e sportit



3.1.8. Ndrëimi në park



### 3.2. Vizioni për parkun e qytetit të Prizrenit për të gjithë


- Parku i qytetit të Prizrenit - park për të gjithë, që ofron mundësi rekreimi, argëtimi dhe relaksimi për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie, moshe, aftësie, apo situatë financiare, etj.
- Parku i qytetit të Prizrenit – park atraktiv, që me programin e ngjeshur të aktiviteteve në kohë të ndryshme të ditës dhe në stinë të ndryshme, siguron vitalitet dhe frekuencë të lartë të qytetarëve të Prizrenit.
- Parku i qytetit të Prizrenit – park pa barriera, që ofron të mirat e veta mjedisore, hijen, diellin, qetësinë, gjelbërimin dhe argëtimin e lojën, të gjithë qytetarëve të Prizrenit.





3.3. Koncepti për parkun e qytetit të qashtëm për të gjithë është i shtruar në 4 shtylla kryesore:

1. Lidhja e parkut të qytetit me kampusin universitar të Universitetit “Ukshin Hoti”. Kampusi universitar karakterizohet me gjelbërim të bujshëm sikurse parku. Aktualisht parku edhe kampusi universitar janë të rrethuara me mur dhe gardh metalik, ndërsa rruga që i ndan në mes, nuk mund të zhvillojë vitalitet për shkak të këtyre gardheve. Që të vitalizohet rruga (që njerëzit të ecin më ngadalë dhe të ndalen në të; që disa banka të parkut të kthehen nga rruga; të krijohet ulje në disa pjesë të murit të ultë rrethues te kampusi) propozojmë largimin e rrethojave dhe mureve në të dy anët.



**Lidhja e parkut të qytetit me Universitetin “Ukshin**

**Hoti”, si dhe qasjet tjera nga qytetit për te parku.**

2. Të përmirësohet qasshmëria e rrugëve për në park (duke përfshirë edhe ofrimin e transportit urban të qasshëm) dhe e shtigjeve përbrenda parkut. Trotuaret e qytetit të Prizrenit duhet të lirohen nga pengesat (makina, mallra, reklama), duhet të riparohen dhe në vendkalime për këmbësor duhet vendosur pjerrina. Trotuaret po ashtu, duhet të përmbajnë vija dhe fusha taktore të cilat po ashtu duhet të kenë ngjyrë kontraktuese në raport me ngjyrën e rrugës, për të mundësuar lëvizjen e të verbërve, respektivisht, të personave me shikim të dobësuar. Shtigjet e brendshme, sipas propozimit, duhet të jenë të qasshme për të verbër përmes taktoreve, si dhe një pjesë e shtigjeve shumë të pjerrëta duhet t'u zbutet pjerrtësia, me çka mundësohet qarkullim i papenguar gjithandej parkut për të gjithë qytetarët. Dhe mbi të gjitha, të promovohet transporti i qëndrueshëm dhe lëvizja këmbësorike—shtohet shtegu i biçiklistëve në rrugë; nivelizohet rruga me trotuar; zvogëlohet shpejtësia e makinave në 30km/h, etj.

Shtigjet e qasshme **1**  
për të verbër (me  
taktile)

e kaltër - shtigjet e **2**  
qasshme me karrocë  
oker - shtigjet e  
paqasshme për PAK  
me karrocë


Harta e të gjitha **3**  
shtigjeve




**Shtigjet dhe qasshmëria e tyre për komunitetin  
PAK jashtë dhe përbrenda parkut.**



3. Parku qytetarëve duhet të ofrojë mundësi të relaksimit apo argëtimit në grup apo vetëm. Andaj, shpërndarja e aktiviteteve, bëhet asisoj, që të mundësojë qytetarëve të shfrytëzojnë parkun në shumë mënyra. Zonat më aktive dhe më të zhurmshme janë të koncentruara në zonën më të diellzuar. Këto zona mund të jenë më të frekuentuara nga të rinjtë, fëmijët apo qytetarët fizikisht aktivë, ndërsa zonat e gjelbëruara ofrojnë hije dhe qetësi për më të moshuarit, ose për ata që duan të kalojnë kohën në park duke u relaksuar, apo lexuar nën hijen e pemëve.



4. Përqendrimi i aktiviteteve, edhe në gjendjen e propozuar, do të jetë kryesisht në zonat ku tashmë ekzistojnë ndërtesat dhe fushat e sportit dhe lojës. Rregullimi i tualeteve publike te lokali shërbyes dhe te ndërtesa e tualeteve publike, si dhe shtimi në secilën nga këto tualete për persona me aftësi të kufizuara, do të mundësojë frekuencë më të lartë të këtij komuniteti në park. Në objektin e tualeteve publike, shtohet edhe një kthinë sanitare për ndërrimin e foshnjave, e cila gjendet në afërsi të këndit të lodrave për fëmijë.



**Harta e aktiviteteve dhe intervenimeve kryesore ndërtuese.**

### 3.4. Rekomandimet dizajnuese për realizimin e parkut të shfrytëzueshëm nga të gjithë qytetarët

**Rekomandimi 1:** *Të mundësohet qasja për persona me aftësi të kufizuara nga qyteti në parkun e qytetit.*

Rrugët për të arritur në park të qytetit, në të gjitha drejtimet, janë përplot barriera arkitektonike për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, por edhe të qytetarëve të tjerë. Kjo situatë e bën të pamundshme lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara, mbërritjen nga pjesë të tjera të qytetit (jo vetëm të personave me aftësi të kufizuara, por edhe të moshuarve dhe qytetarëve të tjerë). Transporti urban është i paqasshëm për PAK, trotualet janë përplot pengesa, vendkalimet për këmbësor nuk kanë pjerrina, mungojnë vijat dhe fushat taktore për lëvizjen e të verbërve, etj.

**11.** Aktualisht ekziston një ndalesë autobusi në skaj të zonës ku kampusi universitar lidhet me zonën e spitalit. Ndalesa nuk ka stacion për pritje. Autobusët që qarkullojnë në linjat e qytetit të Prizrenit janë të paqasshëm për persona me aftësi të kufizuara, por edhe për prindër që lëvizin me karroca për fëmijë. Propozojmë që në vendin e tanishëm ku ndalojnë autobusët, të ndërtohet një stacion, i cili do t'i shërbejë parkut të qytetit, spitalit dhe universitetit "Ukshin Hoti", të cilët gjenden fare pranë parkut.

**12.** Rekomandojmë shtrimin e fushave dhe vijave taktore në trotuare, konform kërkesave dhe parametrave të parashtruara në UA 33/2007. Fushat dhe vijat taktore ndihmojnë lëvizjen e personave të verbër – përdorues të shkopit të bardhë. Fushat taktore në trotuare kryesisht vendosen te vendkalimet për këmbësorë.

**13.** Rekomandojmë vendosjen e pjerrinave me pjerrtësi të përshtatshme për lëvizjen e përdoruesve të karrocave në vendkalime për këmbësorë.

**14.** Rekomandojmë nivelizimin e sipërfaqes së trotuarit dhe rrugës qarkulluese. Rruga qarkulluese të ngrihet në nivel të trotuarit. Me këtë veprim do të krijohet një sipërfaqe e ndarë nga të gjithë, në të cilën shpejtësia do të kufizohet në 30 km/h, dhe do të promovohet lëvizja në këmbë, lëvizja për persona që përdorin karroca, lëvizja e personave të verbër, biçiklistëve, fëmijëve, të moshuarve, etj. Gjerësia e rrugës qarkulluese që e tangjenton parkun, nga ana e parkut është më e gjerë. Në atë vend, rekomandojmë shtrimin e një shtegu për biçikletë. Propozojmë që ky shteg të jetë pjesë e një rrjeti më të gjerë të shtigjeve të biçikletave, përmes të cilit do të promovohet kjo mënyrë e qëndrueshme e lëvizjes në qytet, dhe do të ulet numri i makinave në rrugë.



Rekomandimi 1: Të mundësohet qasja për persona me aftësi të kufizuara nga qyteti në parkun e qytetit.

12. Rekomandojmë shtrimin e fushave dhe vijave taktore në trotuare, konform kërkesave dhe parametrave të parashtruara në UA 33/2007. Fushat dhe vijat taktore ndihmojnë lëvizjen e personave të verbër – përdorues të shkopit të bardhë. Fushat taktore në trotuare kryesisht vendosen te vendkalimet për këmbësorë.

14. Rekomandojmë nivelizimin e sipërfaqes së trotuarit dhe rrugës qarkulluese. Rruga qarkulluese të ngrihet në nivel të trotuarit. Me këtë veprim do të krijohet një sipërfaqe e ndarë nga të gjithë, në të cilën shpejtësia do të kufizohet në 30 km/h, dhe do të promovohet lëvizja në këmbë, lëvizja për persona që përdorin karroca, lëvizja e personave të verbër, biçiklistëve, fëmijëve, të moshuarve, etj. Gjerësia e rrugës qarkulluese që e tangjenton parkun, nga ana e parkut është më e gjerë. Në atë vend, rekomandojmë shtrimin e një shtegu për biçikletë.

Propozojmë që ky shteg të jetë pjesë e një rrjeti më të gjerë të shtigjeve të biçikletave, përmes të cilit do të promovohet kjo mënyrë e qëndrueshme e lëvizjes në qytet, dhe do të ulet numri i makinave në rrugë.



0 1m 3m 6m

14. Profili i rrugës - rruga qarkulluese ngrihet në nivel të trotuarit. Nga ana e parkut rruga është më e gjerë, prandaj propozojmë shtrimin e një shtegu për biçikletë.



**Rekomandimi 2:** Të zvogëlohet pjerrtësia e shtigjeve përbrenda parkut (aty ku është e mundshme dhe e domosdoshme) për të pasur qasje të plotë për persona me aftësi të kufizuara në parkun e qytetit. Si dhe të ndërtohet rampa përbri shkallëve të parkut që çojnë te Universiteti.

Parku i qytetit të Prizrenit karakterizohet me një terren të pjerrët, prandaj edhe lëvizja brenda tij në disa vende është e vështirësuar. Disa shtigje janë me pjerrtësi të madhe, të papërballueshme për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara që përdorin karroca, por edhe nga persona të tjerë që kanë vështirësi në lëvizje (të moshuarit, personat që lëvizin me shëtitore, etj.). Gjatë analizës së lokacionit kemi vërejtur se në disa vende zbutja e pjerrtësisë nënkupton intervenime inxhinierike të shumta që mund të rrisin shumë koston e intervenimit. Intervenimet fizike të reja nuk duhet të krijojnë barriera të reja fizike në shtigjet ekzistuese. Duke e pasur këtë parasysh, propozojmë dy skenarë për përmirësimin e qasshmërisë së shtigjeve.


- **Skenari A:** vendosja e gardheve në të dy anët e shtigjeve të pjerrëta, për të lehtësuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Këto gardhe duhet të projektohen konform kërkesave për qasje për PAK (neni 10 i UA 33/2007). Ky skenar parashihet të jetë afatshkurtër dhe ka për qëllim të shërbejë si masë e përmirësimit të përkohshëm të qasjes.
- **Skenari B:** përmirësimi i pjerrtësisë së shtigjeve përmes intervenimeve inxhinierike. Në këtë drejtim, janë analizuar shtigjet e parkut dhe janë gjetur pozitat, ku mund të bëhet *zbutja* e pjerrtësisë për të lejuar që përdoruesit e karrocave të shfrytëzojnë më mirë parkun.

**I.1.** Intervenimi i parë i tillë është te shtegu në anën veriore të parkut, i cili lidh hyrjen veriore në park (përbri stadiumit “Përparim Thaçi”) me pjesën qendrore të sportit. Përmirësimi i pjerrtësisë në këtë pjesë sugjerohet përmes zhvendosjes së seksionit të pjerrtë të shtegut në të djathtë të shtegut ekzistues, si dhe zgjatjes së shtegut për aq sa të mundësohet një pjerrtësi integrale rreth 8%.



Rekomandimi 2: Të zvogëlohet pjerrtësia e shtigjeve përbrenda parkut (aty ku është e mundur dhe e domosdoshme) për të pasur qasje të plotë për persona me aftësi të kufizuara në parkun e qytetit.

I.1. Përmirësimi i pjerrtësisë në këtë pjesë sugjerohet përmes zhvendosjes së seksionit të pjerrtë të shtegut nga pozita ekzistuese në të djathtë të shtegut ekzistues, si dhe zgjatjes së shtegut për aq sa të mundësohet një pjerrtësi integrale rreth 8%. Kjo zhvendosje e këtij seksioni ndodh për arsye të ruajtjes së një peme ekzistuese përbri shtegut, e cila nëse do të ndërvehohej me gërmim për zbutjen e pjerrtësisë në pozitën aktuale, do të duhej të largohej krejtësisht.




Për këtë intervenim kërkohen punë inxhinierike të përmirësimit të pjerrtësisë së shtegut (gërmim dhe shtim të dheut, si dhe punë përforcuese betonuese në cepin e rënies së terrenit). Ky shteg i ri do të ketë gjerësi 200 cm (sikurse në situatën aktuale), do të shtrohet me kubëza betoni, si dhe do të pajiset në të dy anët me rrethoja ndihmëse (sipas nenit 10 të UA 33/2007).

**I.2. Intervenimi i dytë paraqitet në një seksion të shtegut qendror, i cili lidh Universitetin me pjesën qendrore të parkut. Ky seksion aktualisht ka një palë shkallë të një gjerësie rreth 200 cm dhe me basamakë të thellë.**

Sipas skenarit A, si intervenim afatshkurtër parashihet vendosja e rrethojave ndihmëse në të dy anët e shkallëve, të projektuara konform standardeve për shfrytëzim nga personat me aftësi të kufizuara.

Sipas skenarit B, si intervenim afatgjatë, kemi paraparë ndërtimin e një rampe, krahas shkallëve ekzistuese, me pjerrtësi integrale ~ 8%. Gjerësia e rampës do të jetë rreth 120 cm, ndërsa parashihet që në intervalet prej 6 m të parashihet nga një pushimore me gjatësi prej 150 cm. Për realizimin e rampës do të nevojiten punë inxhinierike të gërmimit dhe të betonimit të mureve anësore përforcuese (për të evituar derdhjen e dheut). Rampa parashihet të pajiset në të dy anët me rrethoja ndihmëse të projektuara konform standardeve për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara.






**Rekomandimi 3:** Të përmirësohet qasja për persona me aftësi të kufizuara në urën mbi lumin Lumbardh që lidh pjesën veriore të parkut me pjesën tjetër të qytetit.

Lumi Lumbardh kufizon pjesën veriore dhe veri-perëndimore të parkut të qytetit. Në anën tjetër të lumit gjendet një bllok banesash, si dhe ekziston lidhja e drejtpërdrejtë me Zonën Industriale të qytetit. Në këtë pjesë ekziston një urë metalike, qasja në të cilën nga ana veriore, gjegjësisht nga ana e bllokut të banesave është në nivel me terrenin, ndërsa në anën jugore të saj, aty ku lidhet me Parkun e Qytetit, ka



disnivel prej 95 cm. Ura aktualisht ka një shkallë dhe një rampë për kapërcimin e këtij disnivele, por pjerrtësia e kësaj të fundit është rreth 100%, që e bën të pashfrytëzueshme nga persona me aftësi të kufizuara, si dhe nga prindër me karroca dhe të tjerë. Ura, shkallët dhe rampa janë të shtruara me dërrasa, të cilat për shkak të ekspozimit ndaj kushteve atmosferike, si dhe nga vandalizimet nga grupet e ndryshme, janë të dëmtuara shumë.

Intervenimi i cili propozohet për përmirësimin e qasjes për persona me aftësi të kufizuara është ndërtimi i një rampe në anën e majtë të urës (ana nga parku) me pjerrtësi integrale prej ~ 5%. Meqë disnivele është rreth 95 cm, rampa rezulton të jetë dy krahësh me gjatësi prej 19 m, dhe e pajisur në të dy anët me rrethoza ndihmëse të projektuara konform kërkesave të parashtruara me UA 33/2007. Gjerësia e rampës do të jetë 150 cm, ndërsa sipërfaqja e saj me material jo rrëshqitës. Rampa mund të ndërtohet nga konstruksioni metalik dhe veshje druri, ose me konstruksion të betonit.






**Rekomandimi 4:** Të ofrohen parkingje për persona me aftësi të kufizuara në vend parkingjet ekzistuese në park.

Aktualisht, në parkun e qytetit të Prizrenit nuk ka parkingje të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara. Pranë hyrjes së skajshme perëndimore, përbrenda parkut gjendet një vend-parkim për vetura që nuk ka vende të shënuara. Hapësira ka gjerësi rreth 15 m dhe thellësi rreth 11 m. Përbrenda parkut, në zonën qendrore fare pranë lokalit gjendet një hapësirë tjetër për parkim, e cila po ashtu nuk ka vende të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara. Në pjesën lindore të parkut, në cepin e jashtëm të saj, ekziston një hapësirë që kufizohet me murin e stadiumit “Përparim Thaçi”, e cila ndonjëherë shfrytëzohet për parkim, edhe pse nuk është e destinuar për këtë funksion.


**I.1.** Pranë hyrjes perëndimore, në hapësirën ekzistuese e cila tashmë përdoret si parking të shënohen vendparkingjet konform përmasave standarde. Një nga këto sipërfaqe të dedikohet për parkim të veturave të personave me aftësi të kufizuara. Vend parkimi i dedikuar për persona me aftësi të kufizuara dallon prej vend parkingjeve të tjera për nga përmasat (gjerësisë standarde të parkingut i shtohet një gjerësi prej 150 cm), si dhe përmban shenjëzimin ndërkombëtar në sipërfaqen që është e dedikuar për parkim, por edhe me shenjëzimin vertikal.



**I.2.** Meqë konsiderojmë se parkut duhet t’ia ruajmë veçoritë mjedisore dhe ta mbrojmë sa më shumë nga gazrat e veturave, propozojmë që hapësira qendrore e parkimit pranë lokalit të largohet krejt. Në këtë hapësirë, përmes modifikimit të përmasave, propozojmë të vendosim një zonë aktivitetesh të përshkruar në rekomandimin 13.

**I. 3.** Në hapësirën e që gjendet në cepin lindor të parkut, gjegjësisht në pjesën kufizuese me stadiumin “Përparim Thaçi” propozojmë krijimin e parkingjeve të reja, të cilët do t’i shërbenin qytetarëve që do të vinin në parkun e qytetit nga pjesët më të largëta të qytetit. Në atë vend, po ashtu propozojmë që njëri

nga parkingjet të dimensionohet konform përmasave standarde për parkingje për persona me aftësi të kufizuara, si dhe të shënjohet me shenjat ndërkombëtare horizontale dhe vertikale.



**Rekomandimi 5:** Të krijohen tualetet publike për persona me aftësi të kufizuara përbrenda parkut të qytetit.

Në parkun e qytetit, tualete publike ekzistojnë në dy struktura. Ndërtesa e lokalit shërbyes e cila gjendet në pjesën qendrore të parkut, në pjesën e prapme, dhe me hyrje nga jashtë përmban një hapësirë tualeti, e cila përbrenda është e ndarë në disa kabina. Kjo hapësirë nuk është e ndarë në baza gjinore, si dhe nuk ka hapësirë të dimensionuar dhe të pajisur, por as të adaptueshme për shfrytëzim nga personat me aftësi të kufizuara. Në pjesën verilindore të parkut gjendet ndërtesa përdhese e tualeteve publike, e cila i ka dy hyrje dhe dy hapësira të ndara në gjini. Hapësirat përbrenda janë organizuara me kabina dhe të pajisura me elemente të sanitareve sipas gjinive. Aktualisht, kjo ndërtesë është e lënë padore dhe nuk mirëmbahet, me inventar pjesërisht të munguar dhe të dëmtuar. Në këtë gjendje ndërtesa është krejtësisht e pashfrytëzueshme.

**I.1.** Në ndërtesën e lokalit, propozohet që të riorganizohen hapësira ekzistuese e tualetit dhe e depos që gjendet përkrah tij. Me zvogëlimin e hapësirës së depos dhe integrimin e një pjese të hapësirës së saj me hapësirën ekzistuese të tualeteve, krijohet hapësirë e mjaftueshme për organizimin e tualeteve për meshkuj, tualeteve për femra si dhe të tualetit për persona me aftësi të kufizuara. Në hyrjen ekzistuese, e cila do të shërbejë edhe në situatën e riorganizuar, do të shtohet një pjerrinë, e cila do të ndihmojë kapërcimin e disnivelit ekzistues prej 15 cm.




Rekomandimi 5: Të krijohen tualetet publike për persona me aftësi të kufizuara përbrenda parkut të qytetit.

I.1. Në ndërtesën e lokalit shërbyes, propozohet që të riorganizohen hapësira ekzistuese e tualetit dhe e depos që gjendet përkrah tij. Me zvogëlimin e hapësirës së depos, dhe integrimin e një pjese të hapësirës së saj me hapësirën ekzistuese të tualeteve, krijohet hapësirë e mjaftueshme për organizimin e tualeteve për meshkuj, tualeteve për femra si dhe të tualetit për persona me aftësi të kufizuara.

Në hyrjen ekzistuese, e cila do të shërbejë edhe në situatën e riorganizuar, do të shtohet një pjerrinë, e cila do të ndihmojë kapërcimin e disnivelit ekzistues prej 15 cm.

Në vizatim janë dhënë 2 variantat e zgjidhjes së tualeteve.



0 1m 3m 6m

**I.2.** Në ndërtesën e tualeteve publike, propozohet që të shtohen dy anekse pranë të dy hyrjeve. Në aneksin e parë krijohet hapësira për tualet për persona me aftësi të kufizuara, ndërsa në aneksin e dytë krijohet hapësira për ndërrimin e foshnjave. Ndërtesa do të pajiset edhe me shenjëzimin e nevojshëm për PAK.



Rekomandimi 5: Të krijohen tualetet publike për persona me aftësi të kufizuara përbrenda parkut të qytetit.

1.2. Në ndërtesën e tualeteve publike, propozohen që të shtohen dy anekse pranë të dy hyrjeve. Në aneksin e parë krijohet hapësira për tualet për persona me aftësi të kufizuara, ndërsa në aneksin e dytë krijohet hapësira për ndërrimin e foshnjave. Ndërtesa do të pajiset edhe me shenjëzimin e nevojshëm për PAK.



0 1m 3m 6m



**Rekomandimi 6:** Të lidhet zona e parkut me zonën e Universitetit “Ukshin Hoti”

Parku i qytetit të Prizrenit gjendet në një zonë të qytetit e cila cilësohet nga gjelbërimi. Në anën tjetër të rrugës së parkut të qytetit gjendet kampusi i universitetit “Ukshin Hoti”. Aktualisht edhe parku edhe kampusi universitar janë të rrethuara nga rrethoja metalike dhe mure të ulëta nga betoni dhe guri. Ky lloj rrethimi i bënë këto dy hapësira të mos komunikojnë me njëra tjetrën, por edhe rrugën e cila gjendet në mes tyre të jetë pak e frekuentuar nga këmbësorë.

11. Të largohen rrethojat nga parku i qytetit (në drejtim të rrugës) dhe nga kampusi universitar. Në anën e kampusit, përmes shtigjeve të reja të mundësohet lidhja e brendësisë së kampusit me rrugë. Nga ana e parkut, nga muri i ultë – bazamenti i rrethojës, të krijohen vende-vende banka (të orientuara në të dy anët: nga parku dhe nga rruga) për ulje dhe relaksim të qytetarëve.



**Rekomandimi 7:** Rekomandojmë që bankat për ulje në brendi të parkut të jenë të tipit që mundësojnë uljen edhe të personave shtatshkurtër dhe fëmijëve (të pajisen me anësore dhe kapëse që lehtësojnë uljen). Po ashtu, rekomandojmë që buzë shtigjeve, të zgjerimet në të cilat janë vendosur bankat për ulje, të ekzistojnë hapësira me përmasa të mjaftueshme në të dy anët e tyre për të mundësuar qëndrimin me karroca për persona me aftësi të kufizuara.



- Në skenarin e parë të realizimit të këtij rekomandimi, propozojmë intervenimet afatshkurtra - riparimin e numrit të madh të bankave që janë të prishura dhe të demoluara, dhe përshtatjen e bankave për përdorim të personave shtatshkurtër.
- Në skenarin e dytë të realizimit të këtij rekomandimi, propozojmë intervenimet si në vijim:

**11.** Zgjerohet hapësira në të dy anët e bankave për të lënë lirinë e zgjedhjes së hapësirës për afrimin dhe qëndrimin me karrocë. Njëkohësisht, këto hapësira mund të shërbejnë edhe për vendosjen e karrocave për foshnja.



Rekomandimi 7: Rekomandojmë që bankat për ulje në brendi të parkut të jenë të tipit që mundësojnë uljen edhe të personave shtatshkurtrë dhe fëmijëve (të pajisur me anësore dhe kapëse që lehtësojnë uljen). Po ashtu, rekomandojmë që buzë shtigjeve, të zgjerimet në të cilat janë vendosur bankat për ulje, të ekzistojnë hapësira me përmasa të mjaftueshme në të dy anët e tyre për të mundësuar qëndrimin me karroca për persona me aftësi të kufizuara.

11. Zgjerohet hapësira në të dy anët e bankave për të lënë lirinë e zgjedhjes së hapësirës për afrimin dhe qëndrimin me karrocë. Njëkohësisht, këto hapësira mund të shërbejnë edhe për vendosjen e karrocave për foshnja.



0 1m 3m 6m



**12.** Rekomandojmë vendosjen e disa tipa vendesh për ulje në parkun e qytetit. Përpos bankave klasike, të cilat rekomandojmë të jenë me mbajtëse, propozojmë vendosjen e karrigeve të lëvizshme metalike (sipas shembullit të parkut të Luxembourg-ut në Paris), që do t’iu mundësojnë qytetarëve pozicionim të lirshëm nëpër park, ulje në vendet më të qeta a grumbullimin në zona më aktive.




**Rekomandimi 8:** Rekomandojmë largimin e gjitha disniveleve në shtigjet për ecje nëpër park. Aktualisht në park, në shumicën e rasteve, aty ku kryqëzohen shtigjet (shtigjet për ecje dhe ato për vrapim), paraqiten pragje apo disnivele, të cilat mund të jenë pengesë madhe për përdorues karrocash, për të verbrit, por edhe për fëmijët e të moshuarit. Pragjet paraqiten edhe te shtigjet që çojnë drejtë gazebove (strehët për piknik), por edhe ndërmjet shtegut dhe hapësirës së tarracës së lokalit shërbyes.


11. Largimi i të gjitha pragjeve ndërmjet shtigjeve (te kryqëzimet e shtigjeve të ndryshme).

12. Largimi i pragjeve tek gazebot (strehët) për piknik dhe te tarraca e lokalit shërbyes.



**Rekomandimi 9:** Rekomandojmë dizajnimin dhe ndërtimin e strehëve të reja për piknik nga materiali i drurit. Shtyllat anësore që mbajnë strehën nuk duhet të kenë rrethojë (si në rastin aktual) dhe mobiliari i brendshëm duhet të jetë i qasshëm për PAK. Pranë strehëve, të vendoset një vend për skarë.





**Rekomandimi 10:** Rekomandojmë që mobiliari i strehëve për piknik por edhe i tarracës së lokalit shërbyes të përshtatet për shfrytëzim nga persona me aftësi të kufizuara. Ekzistojnë shumë zgjidhje që do ta bënin këtë të mundshme, por për intervenim të menjëhershëm, mund të përshtatet modeli aktual i bankës së lokalit për të mundësuar qasjen e përdoruesve të karrocave.




**Rekomandimi 11:** Rekomandojmë vendosjen e lodrave për fëmijë, që mund të përdoren nga të gjithë fëmijët pavarësisht aftësisë së tyre. Ekzistojnë dy vende për lojën e fëmijëve pranë ndërtesës së tualetit publik. Lodrat e propozuara nuk janë lodra speciale që përdoren vetëm nga fëmijë me aftësi të kufizuara, por janë të dizajnuara asisoj, që mundësojnë lojën dhe socializimin e të gjithë fëmijëve pa dallim aftësie. Në fund të këtij rekomandimi, tërheqim vëmendjen, që sipërfaqja në të cilën gjenden lodrat e fëmijëve të mos ketë disnivel me shtigjet të cilat çojnë deri te to, për të mos penguar qasjen e fëmijëve të verbër apo edhe të atyre që përdorin karroca.



Rekomandimi 11: Rekomandojmë vendosjen e lodrave për fëmijë, që mund të përdoren nga të gjithë fëmijët pavarësisht aftësisë së tyre. Ekzistojnë dy vende për lojën e fëmijëve pranë ndërtesës së tualetit publik. Lodrat e propozuara nuk janë lodra speciale që përdoren vetëm nga fëmijë me aftësi të kufizuara, por janë të dizajnuara asisoj, që mundësojnë lojën dhe socializimin e të gjithë fëmijëve pa dallim aftësie.

Në fund të këtij rekomandimi, tërheqim vëmendjen, që sipërfaqja në të cilën gjenden lodrat e fëmijëve të mos ketë disnivel me shtigjet të cilat çojnë deri te to, për të mos penguar qasjen e fëmijëve të verbër apo edhe të atyre që përdorin karroca.



0 1m 3m 6m



Rekomandimi 11: Rekomandojmë vendosjen e lodrave për fëmijë, që mund të përdoren nga të gjithë fëmijët pavarësisht aftësisë së tyre. Ekzistojnë dy vende për lojën e fëmijëve pranë ndërtesës së tualetit publik. Lodrat e propozuara nuk janë lodra speciale që përdoren vetëm nga fëmijë me aftësi të kufizuara, por janë të dizajnuara asisoj, që mundësojnë lojën dhe socializimin e të gjithë fëmijëve pa dallim aftësie. Në fund të këtij rekomandimi, tërheqim vëmendjen, që sipërfaqja në të cilën gjenden lodrat e fëmijëve të mos ketë disnivel me shtigjet të cilat çojnë deri te to, për të mos penguar qasjen e fëmijëve të verbër apo edhe të atyre që përdorin karroca.




0 1m 3m 6m



**Rekomandimi 12:** Rekomandojmë që në sipërfaqen aktuale në qendër të parkut të qytetit, ku tashmë gjenden disa pajisje të fitnesit (që janë të dëmtuara), të vendosen pajisje fitnesi që janë të shfrytëzueshme nga të gjithë, e në veçanti nga përdorues karrocash.




**Rekomandimi 13:** Rekomandojmë që në pozitën aktuale të parkingut pranë lokalit shërbyes, të vendoset poligoni për ushtrimin e ngasjes së karrocës për përdorues karrocash (e në veçanti për fëmijë përdorues karrocash). Poligoni duhet të ketë disa elemente fikse, si dhe disa elemente lëvizëse, që në rastet e mospërdorimit, do të mund të strehohen në depo te lokali shërbyes.



**Rekomandimi 14:** Rekomandojmë krijimin e sipërfaqeve të sportit, të cilat do të jenë të përdorshme për të gjithë. Në këtë aspekt duhet të parashihen fusha për lojë të adaptueshme për disa lloj sportesh.


**Rekomandimi 15:** Në qendër të parkut të qytetit, pranë fushave ekzistuese dhe prapa lokalit shërbyes, rekomandojmë krijimin e një fushe multifunkionale për lojë dhe aktivitete të tjera, të dedikuara moshave të ndryshme. Në këtë kontekst, rekomandojmë vendosjen edhe të vendeve për lojë me rërë. Këto vende do të jenë në lartësi dhe do të jenë të qasshme edhe për fëmijët që janë përdorues karrocash. Po ashtu, në këtë sipërfaqe propozojmë vendosjen e tabelën për pingpong, që mund të përdoret nga të gjithë. Krahas lojërave të tjera për fëmijë dhe të rritur, në këtë sipërfaqe propozojmë vendosjen edhe të një këndi për hortikulturë. Ky kënd përbëhet prej një strukture të ngritur, dhe lehtë e qasshme, e cila do të mbushet me dhe, dhe e cila do të shërbejë për të gjithë qytetarët e interesuar.





**Rekomandimi 17:** Rekomandojmë vendosjen e info – pikave në një apo dy pozita të parkut të qytetit. Info – pika do të jetë një strukturë në të cilën qytetarët do të marrin informatat kryesore për aktivitetet dhe programet që do të mbahen në park. Informatat do të jenë të shpallura përmes hartave të fiksuara në tabelë dhe orareve të aktivitete në park, si dhe përmes broshurave dhe fletushkave të ndryshme që do të mund të merren me vete. Rekomandohet, që merren me vete. Rekomandohet, që këto harta dhe fletushka të jenë edhe në gjuhën Braille.

**Rekomandimi 18:** Rekomandohet që pranë info – pikave të vendosen edhe planet orientuese, që të lehtësojnë orientimin e personave të verbër nëpër park. Plani orientues, përmban tabelën në të cilën është harta e parkut dhe informata të tjera që punohen me relief dhe shënohen me shkrimin Braille.



**Rekomandimi 19:** Rekomandojmë rregullimin e trupave ndriçues në park. Aktualisht, një numër shumë i madh i tyre nuk funksionojnë. Disa nga to, poçet elektrike i kanë të prishur, ndërsa disa trupa ndriçues janë pjesërisht apo krejtësisht të shkatërruara. Me këtë intervenim, do të ngrihet niveli i sigurisë në park, dhe do të mundësohej shfrytëzimi i parkut edhe në orët e mbrëmjes. Në një ardhme të afërt, rekomandojmë që këto trupa ndriçues të pajisen me poçe ekonomike.



**SHTOJCAT:**

- PYETËSORI
- PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”
- KONCEPTI
- HARTA E NDËRHYRJEVE FIZIKE TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES PËR PAK NË PARK
- HARTA E ZONAVE TË AKTIVITETEVE TË PROPOZUARA PËR GJALLËRIMIN E PARKUT
- DETAJET
- IMAZHET E VIZIONIMIT

•

**PYETËSORI**



## PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E QASJES DHE SHFRYTËZIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT

### 1. A E VIZITONI PARKUN E QYTETIT NË PRIZREN?

- a. Po
- b. Jo

### 2. PSE E VIZITONI/ SHFRYTËZONI PARKUN E QYTETIT NË PRIZREN?

- a. Relaksim/ për të marrë ajër të pastër
- b. Ushtrime fizike
- c. Për të shëtitur qenin
- d. Vizitë me miq/ familje/ fëmijë
- e. Luaj/ shikoj sport a lojëra
- f. Vrapim
- g. Të shfrytezoj hapësirën për lojëra fëmijësh
- h. Vizita të organizuara educative
- i. Të ngas biçikletën
- j. Të shijoj natyrën/ gjelbërimin
- k. Për të pirë kafe/ pije në lokal
- l. Për të lexuar
- m. Tjetër

### 3. NËSE NUK E VIZITONI PARKUN E QYTETIT, CILA ËSHTË ARSYEJA?

- a. Prania e personave dhe grupeve të dyshimtë
- b. Pajisjet e lojës së fëmijëve/ të rekreacionit janë në gjendje të keqe
- c. Menaxhimi i dobët i parkut (mbeturina, shtigje të dëmtuara, gjelbërimi i pamirëmbajtur, ndriçimi i munguar natën, etj.)
- d. Nuk ka qasje ose qasja është e vështirë (shtigjet e paqasshme, sipërfaqet e dëmtuara, etj.)
- e. Nuk ka tualete publike
- f. Personat që shëtisin qenë të palidhur
- g. Tjetër

### 4. CILAT NGJARJE, AKTIVITETET DO TA PËRMIRËSONIN PËRJETIMIN TUAJ TË PARKUT, APO DO T'JU BËNIN TA VIZITONI PARKUN MË SHPESH?

- a. Më shumë aktivitete sportive për të gjithë
  - b. Aktivitete të organizuara për fëmijë/ familje
  - c. Më shumë muzikë të gjallë nga grupe apo muzikantë lokalë, etj.
  - d. Aktivitete tematike me temë mjedisin, botën shtazore/ bimore (aktivitete për familje, fëmijë, ekspedita për hulumtim/ njohje të mjedisit, etj.)
  - e. Organizimi i festimit të festave të ndryshme për të gjithë (festat kombëtare, etj.)
  - f. Vizita, diskutime me guida të specializuar
  - g. Dizajnimi i veprave të artit publik
  - h. Aktivitete arkistike dhe praktike për komunitetin
  - i. Shfrytëzimi i parkut për qëllime edukative nga shkollat
  - j. Aktivitete sportive dhe rekreative për të gjithë (ushtrime kineze Tai Chi, ecje rekreative, etj.)
5. Ju lutem shënoni edhe ndonjë aktivitet/ ngjarje tjetër që do të donit të shihni në park.

**6. CILAT INTERVENIME FIZIKE NË PARK DO T'JUA PËRMIRËSONIN PËRJETIMIN E PARKUT APO DO T'JU BËNIN TA VIZITONIT MË SHPESH? (rretho më shumë se një përgjigje)**

- a. Parkimi për P.A.K.
  - b. Rregullimi i shtigjeve për shfrytëzim për persona me karroca, të verbër dhe me shikim të dobësuar (zgjerimi, shtrimi i shiritave taktore, evidentimi i skajeve me ngjyra kontrastuese)
  - c. Fushat e lojës për fëmijë të jenë të projektuara për shfrytëzim nga të gjithë
  - d. Fushat e sportit të jenë të dizajnuara për shfrytëzim nga të gjithë
  - e. Ulëset në park të jenë të përshtatshme për të gjithë
  - f. Sipërfaqet për piknik të kenë mundësi qasjeje me karrocë (tavolinat, pozita e bankave, të lejojnë qasjen me karrocë, etj.)
  - g. Lule me ngjyra të forta kontrastuese përgjatë shtigjeve (që të krijojnë skaje të shtigjeve më lehtë të dallueshme, etj.)
  - h. Lule dhe bimësi aromatike përgjatë shtigjeve (për të përmirësuar përjetimin shqisor të parkut, për të orientuar në lëvizje në park, etj.)
  - i. Hartë taktore orientuese, me informata të tjera rreth parkut për orientim të personave të verbër
  - j. Fontana me ujë të pijshëm (fontana të qasshme)
  - k. Tualete publike për të gjithë në park
  - l. Ndriçim i mirë gjatë mbrëmjeve
  - m. Qasje me transport publik
  - n. Rregullimi i qasjes në rrugë dhe trotuare që çojnë deri te parku (zgjerim trotuaresh, rregullim i sipërfaqeve të dëmtuara, heqja e makinave të parkuara, mallit dhe reklamave të shitoreve, shtrimi i trotuareve me vija taktore, etj.)
  - o. Tjetër (të lutem shëno më poshtë)
- 
- 

**7. MOSHA JUAJ**

**8. GJINIA**

- a. M
- b. F

**9. A JENI PERSON ME AFTËSI TË KUFIZUAR?**

- a. Po
- b. Jo
- c. Preferoj mos të deklarohe

**10. JU LUTEM TREGONI CILAT JANË PROBLEMET E PARKUT QË JUA PAMUNDËSOJNË APO VËSHTIRËSOJNË QASJEN NË TË**

---

---

---



# **PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”**





**1** Lidhja e parkut me kampusin universitar përmes brezit të gjelbër

Shtigjet e qashme **1** për të verbër (me taktile)

**2** Hyrjet kryesore në park dhe pozita e stacionit të autobusit urban (katrori)

e kaltër - shtigjet e **2** qashme me karrocë oker - shtigjet e paqashme për PAK me karrocë

**3** Kaltër - qasja me vetura, përfshi qasjen deri te parkingjet E zezë - qasjet tjera këmbësorike

Harta e të gjitha **3** shtigjeve



parkut të qytetit me Universitetin "Ukshin" qasjet tjera nga qytetit për te parku.

Shtigjet dhe qashmëria e tyre për ko PAK jashtë dhe përbrenda parkut.



**1** Pozita e tualeteve të qashme


Hapësira me **1** zhurmë më të madhe përbrenda parkut

**2** Pozita e aktiviteteve kryesore

Zonat me frekuen- **2** tim më të madh përbrenda parkut

**3** Harta e aktiviteteve

Harta e përjetimeve **3** e hirtë - zonë me hije e verdhë - zonë me



aktiviteteve dhe intervenimeve kryesore ndërtuese.


diell Harta e përjetimeve në park.




## **PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”**

- 1. HARTA E NDËRHYRJEVE FIZIKE TË PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES PËR PAK NË PARK**







Rampa  
Ura




Rampa




Tualeti për P.A.K




Hapesira e lire  
te Ulëset




Parkingu



Tualeti për P.A.K



Rampa  
Shkallët



Rruga & Fushat Taktile









## **PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”**

### **3. HARTA E ZONAAVE TË AKTIVITETEVE TË PROPOZUARA PËR GJALLËRIMIN E PARKUT**







Fitnesi per te gjithë




Kendi i lojërave per femije  
-qasje per P.A.K



Uleset e qashme  
Kafeneja




Lojërat per femije  
-qasje per P.A.K




Piknik



Fontana per pirjen e ujit  
-hortikulture, ulese mobile



Poligoni per P.A.K  
si dhe per cikliste



Kendi per ping-pong  
-Lojërat me dhe





# PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”

## 4. DETAJET



## TROTUARE TË QASSHME PËR TË GJITHË




Rekomandimi 1: Të mundësohet qasja për persona me aftësi të kufizuara nga qyteti në parkun e qytetit.

12. Rekomandojmë shtrimin e fushave dhe vijave taktore në trotuare, konform kërkesave dhe parametrave të parashtruara në UA 33/2007. Fushat dhe vijat taktore ndihmojnë lëvizjen e personave të verbër – përdorues të shkopit të bardhë. Fushat taktore në trotuare kryesisht vendosen te vendkalimet për këmbësorë.

14. Rekomandojmë nivelizimin e sipërfaqes së trotuarit dhe rrugës qarkulluese. Rruga qarkulluese të ngrihet në nivel të trotuarit. Me këtë veprim do të krijohet një sipërfaqe e ndarë nga të gjithë, në të cilën shpejtësia do të kufizohet në 30 km/h, dhe do të promovohet lëvizja në këmbë, lëvizja për persona që përdorin karroca, lëvizja e personave të verbër, biçiklistëve, fëmijëve, të moshuarve, etj. Gjerësia e rrugës qarkulluese që e tangjenton parkun, nga ana e parkut është më e gjerë. Në atë vend, rekomandojmë shtrimin e një shtegu për biçikletë.

Propozojmë që ky shteg të jetë pjesë e një rrjeti më të gjerë të shtigjeve të biçikletave, përmes të cilit do të promovohet kjo mënyrë e qëndrueshme e lëvizjes në qytet, dhe do të ulët numri i makinave në rrugë.






Rekomandimi 4: Të ofrohen parkingje për persona me aftësi të kufizuara në vend parkingjet ekzistuese në park.


I.1. Pranë hyrjes perëndimore, në hapësirën ekzistuese e cila tashmë përdoret si parking të shënohen vendparkingjet konform përmasave standarde. Një nga këto sipërfaqe të dedikohet për parkim të veturave të personave me aftësi të kufizuara. Vend parkimi i dedikuar për persona me aftësi të kufizuar dallon prej vend parkingjeve të tjera për nga përmasat (gjerësisë standarde të parkingut i shtohet një gjerësi prej 150 cm), si dhe përmban shenjëzimin ndërkombëtar në sipërfaqen që është e dedikuar për parkim, por edhe me shenjëzimin vertikal.

PARKINGU PËR P.A.K. NË PARKINGUN EKZISTUES PRANË HYRJES PERENDIMORE.




0 1m 3m 6m





Rekomandimi 4: Të ofrohen parkingje për persona me aftësi të kufizuara në vend parkingjet ekzistuese në park.

I. 3. Në hapësirën e që gjendet në cepin lindor të parkut, gjegjësisht në pjesën kufizuese me stadiumin “Përparim Thaçi” propozojmë krijimin e parkingjeve të reja, të cilët do t’i shërbenin qytetarëve që do të vinin në parkun e qytetit nga pjesët më të largëta të qytetit. Në atë vend, po ashtu propozojmë që njëri nga parkingjet të dimensionohet konform përmasave standarde për parkingje për persona me aftësi të kufizuara, si dhe të shënjohet me shenjat ndërkombëtare horizontale dhe vertikale.





PROPOZIMI PËR PARKING TË RI PRANË STADIUMIT. NË ATË PARKING DO TË REZERVOHET NJË VEND PARKIM PËR PAK.



Rekomandimi 2: Të zvogëlohet pjerrtësia e shtigjeve përbrenda parkut (aty ku është e mundur dhe e domosdoshme) për të pasur qasje të plotë për persona me aftësi të kufizuara në parkun e qytetit.

I.1. Përmirësimi i pjerrtësisë në këtë pjesë sugjerohet përmes zhvendosjes së seksionit të pjerrtë të shtegut nga pozita ekzistuese në të djathtë të shtegut ekzistues, si dhe zgjatjes së shtegut për aq sa të mundësohet një pjerrtësi integrale rreth 8%. Kjo zhvendosje e këtij seksioni ndodh për arsye të ruajtjes së një peme ekzistuese përbri shtegut, e cila nëse do të intervenohej me gërmim për zbutjen e pjerrtësisë në pozitën aktuale, do të duhej të largohej krejtësisht.



**RAMPË E RE PËR TË ZBUTUR PJERRTËSINË E MADHE TË SHTEGUT BUZË LUMBARDHIT.**








Rekomandimi 3: Të përmirësohet qasja për persona me aftësi të kufizuara në urën mbi lumin Lumbardh që lidh pjesën veriore të parkut me pjesën tjetër të qytetit.

Propozohet ndërtimi i një rampe në anën e majtë të urës (ana nga parku) me pjerrtësi integrale prej ~ 5%. Meqë disnivele është rreth 95 cm, rampa rezulton të jetë dy krahëshe me gjatësi prej 19 m, dhe e pajisur në të dy anët me rrethoja ndihmëse të projektuara konform kërkesave të parashtruara me UA 33/2007. Gjerësia e rampës do të jetë 150 cm, ndërsa sipërfaqja e saj me material jo rrëshqitës. Rampa mund të ndërtohet nga konstrukcioni metalik dhe veshje druri, ose me konstrukcion të betonit.



### RAMPA E RE E URËS MBI LUMBARDH






Rekomandimi 2: Të zvogëlohet pjerrtësia e shtigjeve përbrenda parkut (aty ku është e mundshme dhe e domosdoshme) për të pasur qasje të plotë për persona me aftësi të kufizuara në parkun e qytetit. Si dhe të ndërtohet rampa përbri shkallëve të parkut që çojnë te Universiteti.

12. Ndërtimi i një rampe, krahas shkallëve ekzistuese, me pjerrtësi integrale ~ 8%. Gjerësia e rampës do të jetë rreth 120 cm, ndërsa parashihet që në intervalet prej 6 m të parashihet nga një pushimore me gjatësi prej 150 cm. Për realizimin e rampës do të nevojiten punë inxhinierike të gërmimit dhe të betonimit të mureve anësore përforcuese (për të evituar derdhjen e dheut). Rampa parashihet të pajiset në të dy anët me rrethoja ndihmëse të projektuara konform standardeve për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara.




## RAMPË E RE TE SHKALLËT EKZISTUESE NË PARK





Rekomandimi 5: Të krijohen tualetet publike për persona me aftësi të kufizuara përbrenda parkut të qytetit.

I.2. Në ndërtesën e tualeteve publike, propozohen që të shtohen dy anekse pranë të dy hyrjeve. Në aneksin e parë krijohet hapësira për tualet për persona me aftësi të kufizuara, ndërsa në aneksin e dytë krijohet hapësira për ndërrimin e foshnjave. Ndërtesa do të pajiset edhe me shenjzimin e nevojshëm për PAK.



**TUALETE TE REJA PËR PAK TE OBJEKTI I  
TUALETEVE PUBLIKE.**








Rekomandimi 5: Të krijohen tualetet publike për persona me aftësi të kufizuara përbrenda parkut të qytetit.

I.1. Në ndërtesën e lokalit shërbyes, propozohet që të riorganizohen hapësira ekzistuese e tualetit dhe e depos që gjendet përkrah tij. Me zvogëlimin e hapësirës së depos, dhe integrimin e një pjese të hapësirës së saj me hapësirën ekzistuese të tualeteve, krijohet hapësirë e mjaftueshme për organizimin e tualeteve për meshkuj, tualeteve për femra si dhe të tualetit për persona me aftësi të kufizuara.


Në hyrjen ekzistuese, e cila do të shërbejë edhe në situatën e riorganizuar, do të shtohet një pjerrinë, e cila do të ndihmojë kapërcimin e disnivelit ekzistues prej 15 cm.

Në vizatim janë dhënë 2 varianta të zgjidhjes së tualeteve.




**NDËRTIMI I TUALETIT PËR PAK NË HAPËSIRËN EKZISTUESE TË TUALETEVE NË LOKALIN SHËRBYES.**





Rekomandimi 12: Rekomandojmë që në sipërfaqen aktuale në qendër të parkut të qytetit, ku tashmë gjenden disa pajisje të fitnessit (që janë të dëmtuara), të vendosen pajisje fitnessi që janë të shfrytëzueshme nga të gjithë, e në veçanti nga përdorues karrocash.




**FITNESI NË TË HAPUR ME PAJISJE QË MUND TË SHFRYTËZOHEN NGA TË GJITHË**







ILUSTRIMI I PAJISJEVE TË FITNESIT QË MUND TË SHFRYTËZOHET NGA TË GJITHË






Rekomandimi 11: Rekomandojmë vendosjen e lodrave për fëmijë, që mund të përdoren nga të gjithë fëmijët pavarësisht aftësisë së tyre. Ekzistojnë dy vende për lojën e fëmijëve pranë ndërtesës së tualetit publik. Lodrat e propozuara nuk janë lodra speciale që përdoren vetëm nga fëmijë me aftësi të kufizuara, por janë të dizajnuara asisoj, që mundësojnë lojën dhe socializimin e të gjithë fëmijëve pa dallim aftësie. Në fund të këtij rekomandimi, tërheqim vëmendjen, që sipërfaqja në të cilën gjenden lodrat e fëmijëve të mos ketë disnivel me shtigjet të cilat çojnë deri te to, për të mos penguar qasjen e fëmijëve të verbër apo edhe të atyre që përdorin karroca.

FUSHË E LOJËS PËR FËMIJË ME PAJISJE DHE LODRA TË PËRSHTATSHME PËR TË GJITHË




0 1m 3m 6m





Rekomandimi 11: Rekomandojmë vendosjen e lodrave për fëmijë, që mund të përdoren nga të gjithë fëmijët pavarësisht aftësisë së tyre. Ekzistojnë dy vende për lojën e fëmijëve pranë ndërtesës së tualetit publik. Lodrat e propozuara nuk janë lodra speciale që përdoren vetëm nga fëmijë me aftësi të kufizuara, por janë të dizajnuara asisoj, që mundësojnë lojën dhe socializimin e të gjithë fëmijëve pa dallim aftësie.

Në fund të këtij rekomandimi, tërheqim vëmendjen, që sipërfaqja në të cilën gjenden lodrat e fëmijëve të mos ketë disnivel me shtigjet të cilat çojnë deri te to, për të mos penguar qasjen e fëmijëve të verbër apo edhe të atyre që përdorin karroca.



**LODRAT PËR FËMIJË TË QASSHME PËR TË GJITHË**

0 1m 3m 6m




Rekomandimi 15: Në qendër të parkut të qytetit, pranë fushave ekzistuese dhe prapa lokalit shërbyes, rekomandojmë krijimin e një fushe multifunktionale për lojë dhe aktivitete të tjera, të dedikuara moshave të ndryshme.

Në këtë kontekst, rekomandojmë vendosjen edhe të vendeve për lojë me rërë. Këto vende do të kenë të kombinuara pjesë të ulta dhe të ngritura nga toka, dhe do të jenë të qasshme edhe për fëmijët që janë përdorues karrocash.


Po ashtu, në këtë sipërfaqe propozojmë vendosjen e tabelës për ping-pong, që mund të përdoret nga të gjithë.



Krahas lojërave të tjera për fëmijë dhe të rritur, në këtë sipërfaqe propozojmë vendosjen e një këndi për hortikulturë. Ky kënd përbëhet prej një strukture të ngritur, dhe lehtë e qasshme, që do të mbushet me dhe, dhe në të cilën do të mund të mbillen lule a bimë të tjera nga vet qytetarët.



## FUSHA MULTIFUNKSIONALE


0 1m 3m 6m





Rekomandimi 9: Rekomandojmë dizajnimin dhe ndërtimin e gazebove (strehëve) të reja për piknik, të cilat do të punoheshin tërësisht nga materiali i drurit. Shtyllat anësore që mbajnë strehën nuk do të kenë rrethojë (si në rastin aktual) dhe mobiliari i brendshëm (tavolina me banka për piknik) do të jenë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara. Pranë strehëve, të vendoset një vend për skarrë.

Rekomandimi 10: Rekomandojmë që mobiliari i strehëve për piknik por edhe i tarracës së lokalit shërbyes të përshtatet për shfrytëzim nga persona me aftësi të kufizuara. Ekzistojnë shumë zgjidhje që do ta bënin këtë të mundshme, por për intervenim të menjëhershëm, mund të përshtatet modeli aktual i bankës së lokalit për të mundësuar qasjen e përdoruesve të karrocave.



**STRUKTURA E PIKNIKUT (GAZEBO) ME MOBILIAR TË QASSHËM**





Rekomandimi 7: Rekomandojmë që bankat për ulje në brendi të parkut të jenë të tipit që mundësojnë uljen edhe të personave shtatshkurtër dhe fëmijëve (të pajisen me anësore dhe kapëse që lehtësojnë uljen). Po ashtu, rekomandojmë që buzë shtigjeve, të zgjerimet në të cilat janë vendosur bankat për ulje, të ekzistojnë hapësira me përmasa të mjaftueshme në të dy anët e tyre për të mundësuar qëndrimin me karroca për persona me aftësi të kufizuara.

12. Rekomandojmë vendosjen e disa tipeve të vendesh për ulje në parkun e qytetit. Përpos bankave klasike, të cilat rekomandojmë të jenë me mbajtëse, propozojmë vendosjen e karrigeve të lëvizshme metalike (si te parku i Louxembourg-ut në Paris), që do të mundësonin qytetarëve të pozicionoheshin lirshëm nëpër park, duke iu mundësuar kështu uljen në vendet më të qeta, apo edhe grumbullimin në zona më aktive.

Rekomandimi 16: Rekomandojmë vendosjen e disa krojeve (fontana) të ujit të pijshëm në disa pika të parkut. Aktualisht ekziston vetëm një krrua, i cili gjendet prapa lokalit shërbyes. Krahas këtij, [propozohen që të vendosen disa vende të tjera për ujë të pijshëm në park. Krojet e ujit të pijshëm duhet të jenë të qasshme për të gjithë personat pavarësisht moshe, madhësie të shtatit dhe aftësie.


## KROI ME UJË TË PIJSHËM







Rekomandimi 13: Rekomandojmë që në pozitën aktuale të parkingut pranë lokalit shërbyes, të vendoset poligoni për ushtrimin e ngasjes së karrocës për përdorues karrocash (e në veçanti për fëmijë përdorues karrocash). Poligoni duhet të ketë disa elemente fikse, si dhe disa elemente lëvizëse, që në rastet e mospërdorimit, do të mund të strehohen në depo te lokali shërbyes.




**POLIGONI PËR USHTRIME PËR PËRDORUES KARROCASH**






Rekomandimi 9: Rekomandojmë dizajnimin dhe ndërtimin e gazebove (strehëve) të reja për piknik, të cilat do të punoheshin tërësisht nga materiali i drurit. Shtyllat anësore që mbajnë strehën nuk do të kenë rrethojë (si në rastin aktual) dhe mobiliari i brendshëm (tavolina me banka për piknik) do të jenë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara. Pranë strehëve, të vendoset një vend për skarrë.

Rekomandimi 10: Rekomandojmë që mobiliari i strehëve për piknik por edhe i tarracës së lokalit shërbyes të përshtatet për shfrytëzim nga persona me aftësi të kufizuara. Ekzistojnë shumë zgjidhje që do ta bënin këtë të mundshme, por për intervenim të menjëhershëm, mund të përshtatet modeli aktual i bankës së lokalit për të mundësuar qasjen e përdoruesve të karrocave.




MOBILIARI I QASSHËM NË TARRACËN E LOKALIT



Rekomandimi 7: Rekomandojmë që bankat për ulje në brendi të parkut të jenë të tipit që mundësojnë uljen edhe të personave shtatshkurtër dhe fëmijëve (të pajisen me anësore dhe kapëse që lehtësojnë uljen). Po ashtu, rekomandojmë që buzë shtigjeve, te zgjerimet në të cilat janë vendosur bankat për ulje, të ekzistojnë hapësira me përmasa të mjaftueshme në të dy anët e tyre për të mundësuar qëndrimin me karroca për persona me aftësi të kufizuara.


I1. Zgjerohet hapësira në të dy anët e bankave për të lënë lirinë e zgjedhjes së hapësirës për afrimin dhe qëndrimin me karrocë. Njëkohësisht, këto hapësira mund të shërbejnë edhe për vendosjen e karrocave për foshnja.



BANKAT TË ORGANIZUARA ME HAPËSIRË  
TË MJAFTUESHME ANASH PËR QËNDRIMIN  
PERSONAVE ME KARROCA.



ILUSTRIM I PAJISJEVE NË FUSHËN MULTIFUNKSIONALE



## **PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”**

### **5. IMAZHET E VIZIONIMIT**



## **PROJEKTI I VIZIONIMIT TË PARKUT TË QYTETIT TË PRIZRENIT SI “PARK PËR TË GJITHË”**

### **5. IMAZHET E VIZIONIMIT**

























